



Biblioteka Kombëtare e Kosovës
“PJETËR BOGDANI”



Republika e Kosovës
MINISTRIA E KULTURËS,
RINISË DHE SPORTIT



RAPORT VJETOR 2025

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	7
3. ROLI, MISIONI DHE VIZIONI I BKK-SË.....	9
4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
3.1. Struktura organizative	10
4. BOSHTI STRATEGJIK	11
4.1. Krijimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës	11
4.2. Projekti i Digjitalizimit	12
5. PROGRAMET AKADEMIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL.....	15
6. AKTIVITETET KULTURORE DHE PROGRAMET PUBLIKE.....	16
6.1 Aktivitetet vjetore tradicionale	16
6.1.1. Java e Bibliotekës në Kosovë 2025	16
6.1.2. Dita e Bibliotekës 2025	17
6.2 Ekspozita, aktivitete dhe botime	17
6.2.1. Pavarësia e Kosovës në shtypin shqiptar	17
6.2.2. Ekspozitë në nder të Epopesë së UÇK-së	17
6.2.3. Dita Botërore e Poezisë	18
6.2.4. Dita botërore e librit dhe e së drejtës së autorit	18
6.2.5. Ekspozita Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie	18
6.2.6. Ekspozitë në kuadër të Javës së Bibliotekës: Trashëgimia orientale në Kosovë: Dorëshkrimet orientale në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës	19
6.2.7. Ekspozitë në kuadër të Ditës së Bibliotekës: Nga dorëshkrimi te digjitalja	20
6.2.8. Ekspozitë dokumentare dhe forum me temë Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në bashkëpunim me Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë	20
6.2.9. Shënimi i Ditës së autorëve evropianë	20
6.2.9 Botimi i kompletit Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe	21
6.2.10. Botimi i katalogut “Thesare të Bibliotekës Kombëtare”	21
6.2.11. Katalogët shoqëruar të aktiviteteve dhe ekspozitave	21
7. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE DIPLOMACIA KULTURORE	22
7.1. Panairi i librit në Leipzig	22
7.2. Lobimi dhe anëtarësimi në TRADUKI	23
7.4. Kongresi Botëror i Bibliotekave dhe Informacionit IFLA 2025 – (Astana)	24

7.5. Konferenca e drejtorëve të bibliotekave kombëtare të Evropës juglindore (Shkup)	25
7.6. Vizitat zyrtare	25
7.6.1. Sofje (<i>Hapja e Këndit të Librit të Kosovës në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë</i>)	25
7.6.2. Paris (<i>Vizitë në Bibliotekën Kombëtare të Francës</i>)	26
7.7. Erasmus+ dhe TAIEX: Zhvillimi i kapaciteteve të stafit	26
8. MARRËVESHJET DHE BASHKËPUNIMET KOMBËTARE NDËRINSTITUCIONALE	26
8.1. Marrëveshje me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës	26
8.2. Marrëveshje me Institutin e Historisë "Ali Hadri"	27
8.3. Marrëveshje me Universitetin e Prishtinës	27
8.4. Marrëveshje me Fakultetin Filozofik	27
8.5. Marrëveshje bashkëpunimi MKRS – IKKL – BKK – MZK – UP	27
8.6. Marrëveshje me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë	28
8.7. Bashkëpunimi me Filharmoninë e Kosovës	28
8.9. Bashkëpunimi me Qendrën Kinematografike të Kosovës	28
8.10. Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	29
8.9. Takim me drejtorin e institutit Yunus Emre	29
8.11. Takim me përfaqësues nga diaspora	30
9. MENAXHIMI INSTITUCIONAL	30
9.1. PASURIMI DHE ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE	30
9.1.1. Pasurimi	31
9.1.2. Katalogimi	32
9.1.3. Bibliografia	32
9.1.4. Koleksionet e Veçanta	32
9.2. SHËRBIMI PËR PËRDORUES DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL	33
9.2.1. Shërbimi për Përdorues	33
9.2.2. Depotë dhe koleksionet bibliotekare	33
9.2.3. Aftësimi dhe zhvillimi profesional	34
10. BUXHETI DHE FINANCAT	36
11.1. Ekuivalentimi i pagave të punonjësve profesionalë të Bibliotekës Kombëtare	38
11.2. Trajnimet	39
12. INFRASTRUKTURA, RESTAURIMI DHE INVESTIMET.....	40
12.1. Rifunksionalizimi i amfiteatrit të vogël	40
12.6. Mirëmbajtja e klimakomoreve dhe pajisja me klimakomore të reja	41



12.7. Pajisja me automjete	41
13. PROMOVIMI, SHËRBIMET DHE VIZITORËT.....	41
13.1. Mediet dhe rrjetet sociale	41
13.2. Vizitorët	42
14. FINANCAT DHE PROKURIMI.....	42
14.1 Procedurat e prokurimit	42
15. SFIDAT	52
16. PRIORITETET PËR VITIN 2026	53
17. ANEKS.....	54

Lista e tabelave

Tabela 1. Tabela përmbledhëse e punëve të realizuara në krijimin e Rrjetit Bibliotekar.....	12
Tabela 2. Paraqitja e rritjes së volumit të faqeve të digjitalizuara nga operatori ekonomik gjatë periudhës raportuese	13
Tabela 3. Përmbledhja e aktiviteteve të grupit punues për digjitalizimin e koleksioneve të veçanta	14
Tabela 4. Paraqitja e formave të pasurimit të fondit bibliotekar	31
Tabela 5. Përmbledhje e shërbimeve bibliotekare dhe numrit të përdoruesve	33
Tabela 6. Përmbledhje e punëve të Divizionit të Aftësimin dhe Zhvillimit Profesional.....	34
Tabela 7. Përmbledhje e punëve të Bibliotekës Digjitale	35
Tabela 8. Përmbledhje e aktiviteteve që ndërlidhen me projektin e ASHI-së	35
Tabela 9. Buxheti në formë tabelare për periudhën kohore janar-dhjetor 2025 në €.....	36
Tabela 10. Raporti për të hyrat vetanake.....	37
Tabela 11. Trajnimet e stafit në vitin 2025.....	39
Tabela 12. Procedurat e prokurimit në BKK sipas periudhave kohore.....	42
Tabela 13. Lista e procedurave të prokurimit	44

Lista e figurave

Figura 1. Struktura organizative e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani"	10
Figura 2. Takim me bibliotekat komunale për prezantimin e platformës KOHA	11
Figura 3. Lidhja e bashkëpunimit me UP-në	15
Figura 4. Shënimi i Ditës së autorëve evropianë.....	20
Figura 5. Dhurimi i kompletit të vëllimeve Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe për Muzeun e Masakrës.....	21
Figura 6. Katalogu Thesare të Bibliotekës Kombëtare.....	21
Figura 7. Stenda e Kosovës dhe ngjarjet letrare të BKK-së në Panairin e Librit në Leipzig	23
Figura 8. Nga takimi me drejtoreshën e Panairit të Leipzigut, znj. Astrid Böhmisch	23
Figura 9. Materialet e shkëmbyera mes BKK-së dhe Bibliotekës së Kongresit.....	24
Figura 10. BKK në Kongresin Botëror të Bibliotekave dhe Informacionit në Astana, Kazakistan	24
Figura 11. Takimi mes drejtorëve të bibliotekave kombëtare të Evropës juglindore dhe pjesëmarrja në konferencën e parë ndërkombëtare për Trashëgiminë kulturore në Shkup, Maqedoni e Veriut.....	25
Figura 12. Vizita zyrtare në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë.....	25
Figura 13. Vizita zyrtare në Bibliotekën Kombëtare të Francës	26
Figura 14. Nënshkrimi i marrëveshjes me u.d. Drejtorin e ASHAK, z. Mehmed Xhemajli	27
Figura 15. Nënshkrimi i marrëveshjes me drejtoreshën e Institutit të Historisë, znj. Teuta Shala Peli	27
Figura 16. Nënshkrimi i marrëveshjes me rektorin e Universitetit të Prishtinës, z. Arben Hajrullahu	27
Figura 17. Nënshkrimi i marrëveshjes me drejtorin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, z. Piro Misha	28
Figura 18. Performanca e Filharmonisë së Kosovës në hapjen solemne të Javës së Bibliotekës 2025	28
Figura 19. Performanca e Baletit të Kosovës në ceremoninë e Ditës së Bibliotekës 2025	28
Figura 20. Shfaqja e filmit "Zgjoj" në amfiteatrin e vogël të BKK-së	28
Figura 21. Promovimi i librit të Radomir Dimiq në BKK	29
Figura 22. Dhurimi i pianos nga MKRS-ja për BKK-në.....	29
Figura 23. Takim me drejtorin e Institutit Yunus Emre, z. Ramazan Yilmaz	29
Figura 24. Takimi me KFOR-in italian	29
Figura 25. Takimi me përfaqësues nga diaspora në BKK.....	30
Figura 26. BKK në takimin Rajonal të ISBN-së dhe ISMN-së	30
Figura 27. Biblioteka e Artit Bashkëkohor para dhe pas riorganizimit të fondit	34
Figura 28. Diagram i raportit të shpenzimeve kapitale	37
Figura 29. Diagram i shpenzimeve komunale.....	37
Figura 30. Trajnimet e mbajtura në BKK.....	40
Figura 31. Renovimi i amfiteatrit të vogël	40
Figura 32. Trezori i Koleksioneve të Veçanta në BKK	40

<i>Figura 33. Salla e periodikut e rifunksionalizuar.....</i>	<i>40</i>
<i>Figura 34. Pastrimi i mureve të jashtme të BKK-së.....</i>	<i>41</i>
<i>Figura 35. Diagram krahasimi mes ndjekjes në rrjete sociale në vitin 2024 dhe 2025.....</i>	<i>41</i>
<i>Figura 36. Krahasim i numrit të vizitorëve në BKK në vitin 2024 dhe 2025.....</i>	<i>42</i>
<i>Figura 37. Raporti i prokurimit për vitin 2025 i shprehur sipas numrit të procedurave të inicuar.....</i>	<i>43</i>
<i>Figura 38. Raporti i prokurimit për vitin 2025 në bazë të vlerës së kontraktuar.....</i>	<i>43</i>

1. Hyrje

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2025 i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" i përcillet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, me qëllimin e informimit të plotë për veprimtarinë institucionale, sfidat e adresuara dhe prioritetet strategjike të institucionit.

Raporti pasqyron zhvillimet kryesore të vitit 2025, masat e ndërmarra në kuadër të menaxhimit institucional, si dhe orientimin strategjik të Bibliotekës Kombëtare për vitin 2026, duke qenë në harmoni me politikat kulturore dhe kornizën ligjore në fuqi.

2. FJALA E DREJTORESHËS SË PËRGJITHSHME



Biblioteka Kombëtare e Kosovës 'Pjetër Bogdani' (BKK) është institucioni qendror i kulturës, dijes dhe trashëgimisë dokumentare të vendit, një shtyllë themelore e identitetit kulturor dhe zhvillimit intelektual të shoqërisë kosovare.

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2025 paraqet një pamje të aktiviteteve themelore të realizuara nga Biblioteka Kombëtare, duke përfaqësuar kështu një dokument orientues për rolin që ky institucion ka

dhe duhet të ketë në arkitekturën kulturore shtetërore.

Viti 2025 është përshkruar nga momente strategjike dhe esenciale për Bibliotekën Kombëtare, duke hapur një fazë të re zhvillimi për institucionin: kalimin nga një model funksionimi tradicional drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse, moderne, më pranë komunitetit dhe të drejtuar kah e ardhmja, në përputhje me prioritetet e politikave kulturore të Republikës së Kosovës.

Në këtë periudhë janë menaxhuar njëkohësisht sfida institucionale, procese reformuese administrative dhe pritshmëri të larta publike. Fillimi i vitit ishte tejet sfidues për shkak të çështjes së rritjes së pagave për punonjësit profesionalë të Bibliotekës Kombëtare dhe implikimeve financiare që kjo problematikë ka pasur. Në përballje me këtë situatë, menaxhmenti ka vepruar me përgjegjësi institucionale dhe brenda kornizës ligjore, duke ndërmarrë hapa konkretë për rregullimin gradual të statusit profesional të punonjësve. Si rezultat, gjatë vitit që lamë rreth 80 për qind e punonjësve profesionalë janë trajtuar në përputhje me statusin e tyre ligjor si krijues dhe përformues arti e kulture, ndërsa në vitin 2026 parashihet përmbyllja e plotë e këtij procesi.

Pavarësisht këtyre sfidave, në këtë vit, jemi fokusuar kah lëvizjet transformuese. Dy projekte qenësore: krijimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës dhe avancimi i digjitalizimit të trashëgimisë dokumentare, kanë përcaktuar mënyrën se si Biblioteka Kombëtare e koncepton dhe ushtron misionin e saj. Këto projekte, pos avancimit teknologjik të institucionit, përkojnë dhe me politikat publike në funksion të barazisë në qasje, ruajtjes së identitetit kulturor dhe integritetit evropian.

Krijimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës reflekton reformën themelore në fushën e bibliotekarisë publike, duke ndërtuar për herë të parë një sistem të integruar bibliotekar në nivel vendi. Në vitin 2026, fokusi do të jetë konsolidimi i këtij rrjeti, standardizimi i shërbimeve dhe shndërrimi i tij në një instrument funksional të politikave nacionale të dijes dhe edukimit.

Në të njëjtën kohë, digjitalizimi i koleksioneve të veçanta dhe periodikut historik të Kosovës po trajtohet si prioritet shtetëror për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe qasjen e hapur në burime të dijes. Hapat e ndërmarrë gjatë vitit 2025 krijojnë bazën për ndërtimin e arkivit digjital kombëtar, i cili do të jetë një nga shtyllat kryesore të veprimit institucional në vitin 2026 dhe më tej.

Në aspektin kulturor e shkencor, Biblioteka Kombëtare ka forcuar rolin e saj e të qenit qendër aktive e jetës kulturore, dialogut intelektual dhe memories kolektive. Përmes aktiviteteve publike, ekspozitave, forumeve shkencore dhe bashkëpunimeve ndërinstytucionale, Biblioteka ka afirmuar vlerat e librit, leximit dhe trashëgimisë si shenja thelbësore të identitetit nacional.

Prioriteti i këtij viti ka qenë vecanërisht vënia e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në hartën kulturore evropiane, ndaj në planin ndërkombëtar, rritja e pranisë së Bibliotekës në rrjete dhe platforma profesionale ka kontribuar në afirmimin më të madh të Kosovës në hapësirën kulturore evropiane. Angazhime këto, të cilat krijojnë mundësi konkrete për diplomaci kulturore dhe bashkëpunime afatgjata për vitet vijuese.

Në përfundim, viti 2025 qe vit përcaktues i orientimit transformues të Bibliotekës Kombëtare, duke dëshmuar se ky institucion që ruan e mbron trashëgiminë intelektuale, është gjithashtu një palë institucionale me përgjegjësi të drejtpërdrejta në zhvillimin kulturor, arsimor e social të vendit. Prioritetet e vitit 2026 do të ndërtohen mbi këtë bazë, me synimin e shndërrimit të Bibliotekës Kombëtare në një institucion modern, të qëndrueshëm dhe të integruar plotësisht në politikat publike të Republikës së Kosovës.

Blerina Rogova Gaxha,
Drejtoreshë e Përgjithshme e BKK-së

3. ROLI, MISIONI DHE VIZIONI I BKK-SË

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" është qendër e kulturës, dijes dhe trashëgimisë kulturore të vendit. Si institucioni më i lartë bibliotekar në Kosovë, luan një rol kyç në pasurimin e jetës kulturore dhe intelektuale të shoqërisë, përmes koleksioneve të pasura, hapësirave të saj arkitektonike inspiruese dhe ofrimit të shërbimeve të shpejta dhe efikase.

Misioni i Bibliotekës Kombëtare është ruajtja, përpunimi, mbrojtja dhe ofrimi i qasjes së hapur në trashëgiminë kulturore kombëtare, për të mundësuar ruajtjen afatgjatë të identitetit dhe trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e zhvillimit edukativ, shkencor dhe kulturor të shoqërisë.

Vizioni i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës shtrihet përtej rolit tradicional bibliotekar, duke synuar të shndërrohet në një qendër dinamike kulturore, hulumtuese dhe edukative. Në këtë kontekst, BKK kontribuon në promovimin e librit, leximit, dijes dhe kulturës, organizon veprimtari shkencore dhe kulturore, si dhe bashkëpunon me institucione vendore dhe ndërkombëtare për avancimin e shkëmbimit profesional dhe kulturor.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" (BKK) është institucioni qendror bibliotekar i Republikës së Kosovës dhe një shtyllë themelore e politikave shtetërore në fushën e kulturës, dijes dhe trashëgimisë kulturore. Ajo vepron në varësi funksionale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-097 për Bibliotekat, i cili përcakton rolin e bibliotekës në shërbim të interesit publik kulturor, ndërsa organizimi funksional i saj zbaton standardet e Ligjit Nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura.

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2025 dëshmon përkushtimin institucional të Bibliotekës Kombëtare në zbatimin e mandatit të saj ligjor dhe në avancimin e objektivave strategjike shtetërore në fushën e kulturës dhe trashëgimisë. Gjatë këtij viti, Biblioteka Kombëtare ka konsoliduar më tej rolin e saj të institucionit qendror të memories kombëtare, duke vepruar si aktor aktiv në ndërtimin e politikave publike kulturore dhe në afirmimin ndërkombëtar të Kosovës.

Veprimtaria institucionale gjatë vitit 2025 është zhvilluar me fokus të qartë në modernizimin e shërbimeve bibliotekare dhe në ndërtimin e një sistemi të integruar bibliotekar kombëtar, në përputhje me standardet evropiane. Krijimi dhe funksionalizimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës përbën një arritje strukturore me rëndësi strategjike, duke garantuar koordinim institucional, standardizim profesional dhe qasje të barabartë të qytetarëve në burime informative në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Procesi i digjitalizimit të koleksioneve të veçanta dhe periodikut dokumentar të Kosovës, gazetave dhe revistave historike, ka shënuar avancim të dukshëm, duke krijuar bazat për mbrojtjen afatgjatë të trashëgimisë kulturore dhe për integrimin e Bibliotekës Kombëtare në rrjetet ndërkombëtare të dijes dhe qasjes së hapur. Ky proces është i drejtpërdrejtë në funksion të politikave shtetërore për transformimin digjital dhe diplomacinë kulturore.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar intensifikimit të jetës kulturore dhe shkencore, duke organizuar një mori aktivitësh, si promovime librash, hapje ekspozitash, organizime letrare dhe forum memoralizues i ndërlidhur me kujtesën historike. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e rolit të Bibliotekës si qendër kulturore dinamike, duke rritur sensibilizimin kulturor, nxitur mendimin kritik dhe fuqizuar marrëdhëniet me komunitetin akademik, artistik dhe qytetar.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Biblioteka Kombëtare ka shënuar progres të dukshëm nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve me institucione homologe, përfshirë biblioteka kombëtare rajonale dhe më gjerë. Po ashtu, Biblioteka ka marrë pjesë në kongrese dhe organizime ndërkombëtare, si dhe ka promovuar trashëgiminë kulturore dhe bibliotekare të Kosovës në kuadër të diplomacisë kulturore. Këto angazhime kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit institucional dhe forcimin e pozitës së Bibliotekës Kombëtare në nivelin ndërkombëtar.

Në planin e burimeve njerëzore, viti 2025 ka evidentuar qartë nevojën për trajtim të drejtë dhe të qëndrueshëm të statusit profesional të punonjësve të Bibliotekës Kombëtare, në përputhje me përputhje me Shtojcën nr. 12 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Pavarësisht kufizimeve procedurale dhe mungesës së mekanizmave funksionalë të ekuivalentimit në nivel qendror, menaxhmenti i institucionit ka ndërmarrë masa konkrete dhe të përgjegjshme, duke integruar procesin e kategorizimit dhe rregullimit të pagave në planifikimin financiar institucional. Si rezultat, gjatë vitit 2025 është arritur ekuivalentimi i rreth 80% të punonjësve profesionalë, ndërsa përmbyllja e këtij procesi gjatë vitit 2026 mbetet një prioritet institucional që kërkon mbështetje të drejtpërdrejtë nga MKRS dhe institucionet përkatëse qeveritare.

Në aspektin financiar, Biblioteka Kombëtare ka demonstruar kapacitet menaxhues, me realizim prej rreth 93% në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe rreth 84% në Shpenzime Kapitale. Ky nivel realizimi konfirmon se institucioni është i gatshëm të menaxhojë në mënyrë efektive investime të mëtejshme publike, në funksion të prioritetëve në kulturë, arsim dhe transformim digjital.

Në tërësi, viti 2025 përfaqëson një fazë kyçe të konsolidimit institucional dhe funksional të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Arritjet e këtij viti dëshmojnë se Biblioteka Kombëtare është e gatshme të jetë një partner strategjik në hartimin dhe zbatimin e politikave publike kulturore, duke kërkuar njëkohësisht mbështetje të qëndrueshme financiare dhe institucionale për përmbushjen e plotë të mandatit të saj ligjor në vitet në vijim.

3.1. Struktura organizative

Struktura organizative e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani” përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, tri (3) departamente dhe dymbëdhjetë (12) divizione:




Figura 1. Struktura organizative e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”

4. BOSHTI STRATEGJIK

Boshti strategjik i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës përbëhet nga dy projekte kyçe të iniciuara gjatë kësaj periudhe raportuese: Krijimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës dhe Digjitalizimi i Koleksioneve të Veçanta. Nëpërmjet realizimit të projektit të parë, BKK ka arritur ndërtimin e një sistemi të përbashkët bibliotekar në mbarë vendin, duke rritur qasjen e përdoruesve dhe duke përmirësuar shërbimet bibliotekare. Ndërsa, me iniciimin e projektit të dytë, synohet modernizimi i shërbimeve bibliotekare dhe ruajtja afatgjatë e trashëgimisë kulturore kombëtare, duke e bërë të qasshme dhe të hapur, si dhe duke e integruar dhe promovuar në trashëgiminë kulturore ndërkombëtare.

4.1. Krijimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës

Qëllimi i këtij projekti ka qenë ndërtimi i një sistemi të përbashkët, modern dhe të unifikuar për bibliotekat e vendit, me synim përmirësimin e shërbimeve bibliotekare dhe rritjen e qasjes së përdoruesve në burimet informative. Rrjeti Bibliotekar i Kosovës përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të bibliotekarisë dhe krijimit të një katalogu të përbashkët kombëtar. Gjatë realizimit dhe funksionalizimit të këtij projekti janë organizuar një sërë takimesh të vazhdueshme me bibliotekat rajonale, përfshirë tri takime të përbashkëta me drejtorët e bibliotekave publike, si dhe një takim ndërinstitucional, mbajtur më 5 nëntor, për prezantimin e platformës KOHA.



Figura 2. Takim me bibliotekat komunale për prezantimin e platformës KOHA

Gjithashtu, në kuadër të projektit janë realizuar një sërë aktiviteteve teknike dhe organizative, të cilat janë zhvilluar në faza të mirëpërcaktuara.

Fillimisht është realizuar instalimi i platformës bibliotekare (KOHA) dhe krijimi i instancave të veçanta për secilën prej 48 bibliotekave të përfshira në rrjet. Çdo bibliotekë është pajisur me konfigurime funksionale që i mundësojnë përdorimin e pavarur të sistemit, në përputhje me nevojat dhe strukturën e saj organizative. Më pas është instaluar dhe konfiguruar baza qendrore e të dhënave, ndërsa janë vendosur parametrat e nevojshëm për funksionimin e moduleve kryesore të sistemit, përfshirë katalogimin, qarkullimin, menaxhimin e përdoruesve dhe raportimin.

Në fazën pasuese, të gjitha instancat e bibliotekave janë ndërlidhur në një kërkim, e cila u mundëson përdoruesve kërkimin e materialeve bibliotekare nga të gjitha bibliotekat e përfshira në rrjet përmes një pike të vetme hyrëse. Gjithashtu, është instaluar sistemi i monitorimit të performancës, i cili siguron përcjellje të vazhdueshme të funksionimit të platformës dhe ndihmon në identifikimin me kohë të nevojave për ndërhyrje teknike.

Një pjesë e rëndësishme e punës ka qenë migrimi i të dhënave ekzistuese nga sistemet e mëparshme në platformën KOHA. Gjatë këtij procesi janë transferuar të dhëna të shumta bibliografike dhe njësi fizike, duke u siguruar ruajtja e saktësisë dhe integritetit të tyre në sistemin e ri. Pas përfundimit të migrimit, është realizuar testimi i plotë i platformës dhe i të gjitha instancave, me qëllim garantimin e funksionimit të qëndrueshëm përpara vendosjes në përdorim aktiv.

Tabela 1. Tabela përmbledhëse e punëve të realizuara në krijimin e Rrjetit Bibliotekar

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	<i>Instalimi i Platformës për shërbime të bibliotekës (LSP) në server secila bibliotekë një instance</i>	<i>Copë</i>	<i>48</i>
2	<i>Instalimi i bazës së të dhënave</i>	<i>Copë</i>	<i>48</i>
3	<i>Konfigurimi i Platformës për shërbime të bibliotekës (LSP)- secila bibliotekë një instancë</i>	<i>Biblioteka</i>	<i>48</i>
4	<i>Ndërlidhja e të gjitha instancave (48), në një instancë të përbashkët (discovery layer)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
5	<i>Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të gjurmimit</i>	<i>Copë</i>	<i>48</i>
6	<i>Migrimi i të dhënave (120000-150000 bibs; 340000-400000 items)</i>	<i>Total</i>	<i>1</i>
7	<i>Testimi i të gjitha instancave</i>	<i>Copë</i>	<i>48</i>
8	<i>Mirëmbajtja</i>	<i>Vit</i>	<i>1</i>

4.2. Projekti i Digjitalizimit

Projekti i Digjitalizimit është një nga shtyllat kryesore strategjike të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe një ndër prioritetet me të rëndësishme institucionale në drejtim të modernizimit të shërbimeve bibliotekare dhe ruajtjes afatgjatë të trashëgimisë kulturore kombëtare. Përmes këtij projekti synohet transformimi gradual i Bibliotekës nga një institucion tradicional i ruajtjes fizike të fondit bibliotekar në modernizimin e shërbimeve bibliotekare, ruajtja afatgjatë e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe krijimi i një arkivi të qëndrueshëm digjital që mund të shërbejë për kërkime, studime dhe përdorim nga komuniteti akademik dhe publiku i gjerë.

Gjatë vitit 2025, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka avancuar në mënyrë të dukshme procesin e digjitalizimit të koleksioneve të veçanta, përmes kontraktimit të operatorit ekonomik, të lidhur për periudhën kohore 20.10.2025 - 20.10.2026. Vlera totale e kontratës është 270,000 €, ku parashihet të digjitalizohen gjithsej 3,000,000 njësi.

Sipas kësaj kontrate, projekti përfshin një varg aktivitete në funksion të digjitalizimit të koleksioneve të veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe krijimit të arkivit digjital: skanimin e materialeve bibliotekare ekzistuese në format fizik, përfshirë libra, dorëshkrime, gazeta, revista, harta dhe materiale të tjera etj; indeksimin e materialeve të skanuara sipas fushave standarde të katalogimit; konvertimin e dokumenteve në format të kërkueshëm përmes

teknologjisë OCR, me qëllim të mundësimit të kërkimit të përmbajtjes së plotë; kopjimin dhe dorëzimin e materialeve të digjitalizuara në pajisjet përkatëse të storage-it të dedikuar për Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Operatori ekonomik sipas kontratës ka realizuar shërbimet e skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR, duke krijuar arkivin digjital të Bibliotekës Kombëtare. Si rezultat i këtij bashkëpunimi të BKK-së me operatorin ekonomik është ngritur ndjeshëm volumi i punës në digjitalizimin e koleksioneve të veçanta, ku vetëm në një periudhë dymujore (20.10.2025 – 18.12.2025) është arritur të digjitalizohen 627,389 faqe.

Tabela 2. Paraqitja e rritjes së volumit të faqeve të digjitalizuara nga operatori ekonomik gjatë periudhës raportuese

Nr.	Përshkrimi	Java	Sasia e faqeve
1	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 1	65,630
2	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 2	67,192
3	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 3	76,835
4	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 4	75,435
5	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 5	82,663
6	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 6	56,944
7	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 7	114,612
8	<i>Shërbime të skanimit, indeksimit dhe konvertimit OCR të materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital</i>	Java 8	88,078
Gjithsej			
627,389			

Me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës, Biblioteka Kombëtare ka krijuar një grup punues të saj të specializuar, i cili ka zhvilluar aktivitetet në përputhje me procedurat dhe standardet institucionale, duke siguruar cilësi, vazhdimësi dhe koordinim të plotë. Aktivitetet kryesore të grupit punues kanë përfshirë: hartimin dhe ndarjen e detyrave për secilin anëtar të grupit; përzgjedhjen dhe përgatitjen e materialeve prioritare për skanim; evidentimin e të dhënave bibliografike për çdo njësi; dorëzimin dhe kthimin e materialeve në depo pas skanimit; mbikëqyrjen e përditshme të procesit dhe raportimin e ecurisë së punës; hartimin e listave përcjellëse dhe përgatitjen e materialeve për fazat e ardhshme të digjitalizimit.

Procesi i punës është zhvilluar në përputhje me procedurat institucionale, duke siguruar cilësi dhe vazhdimësi në të gjitha fazat. Aktivitetet e realizuara përfshijnë: përgatitjen dhe evidentimin bibliografik të materialeve; dorëzimin për skanim të listave kryesore dhe listave të riskenimit; kthimin dhe sistemimin e njësive në depo dhe ndërhyrjen restauruese për njësi (ndarja e fletëve të ngjitura).

Procesi i digjitalizimit është zhvilluar sipas dinamikës së planifikuar, ndërsa bashkëpunimi me operatorin ekonomik ka qenë funksional, i rregullt dhe koherent.

Në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK) janë digjitalizuar edhe numrat e munguar të gazetës Rilindja, të viteve 1945-1963. Gjithsej janë digjitalizuar 122,714 faqe në format A3.

Tabela 3. Përmbledhja e aktiviteteve të grupit punues për digjitalizimin e koleksioneve të veçanta

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Sasia/periudha kohore
1	<i>Përzgjedhja e materialeve</i>	<i>Përzgjedhja e librave të vjetër dhe të rrallë me ndjeshmëri të lartë fizike dhe vlerë të veçantë dokumentare</i>	<i>1.780 njësi të tërhequra nga depoja</i>
2	<i>Përgatitja e materialeve</i>	<i>Përgatitje fizike dhe teknike për digjitalizim, përfshirë evidentimin e të dhënave për secilën njësi</i>	<i>1.780 njësi</i>
3	<i>Ndërhyrje restauruese</i>	<i>Ndarje e fletëve të ngjitura dhe ndërhyrje të domosdoshme për sigurinë e materialit dhe cilësinë e skanimit</i>	<i>182 njësi</i>
4	<i>Hartimi i listave për skanim</i>	<i>Përgatitje e listave përcjellëse për Operatorin Ekonomik</i>	<i>51 lista për skanim</i>
5	<i>Hartimi i listave për riskenim</i>	<i>Përgatitje e listave për riskenimin e materialeve</i>	<i>10 lista për riskenim</i>
6	<i>Dorëzimi i materialeve</i>	<i>Dorëzim fizik i materialeve te Operatori Ekonomik për skanim</i>	<i>57 lista gjithsej</i>
7	<i>Procesi i skanimit</i>	<i>Digjitalizimi i materialeve sipas listave të miratuara</i>	<i>1.222 njësi / 395,270 faqe</i>
8	<i>Riskenimi</i>	<i>Riskenim i materialeve me cilësi të pamjaftueshme në skanimin fillestar</i>	<i>1 përfshirë në total</i>
9	<i>Mbikëqyrja dhe kontrolli i cilësisë</i>	<i>Verifikim i vazhdueshëm i cilësisë së skanimit dhe përputhshmërisë së materialeve</i>	<i>Gjatë gjithë procesit</i>

10	<i>Kthimi i materialeve</i>	<i>Kthimi, sistemimi dhe vendosja në raftet e materialeve pas përfundimit të skanimit</i>	<i>1.222 njësi</i>
11	<i>Organizimi i listave të skanimit</i>	<i>Strukturimi i listave sipas numrit të njësisë (20, 30, 11, 32, 34, 24, 9 njësi)</i>	<i>Periudha 15.10– 26.12.2025</i>
12	<i>Procesi i skanimit</i>	<i>Përzgjedhja e periodikut</i>	<i>231, 443 faqe</i>
13	<i>Digjitalizimi në bashkëpunim me ASHAK</i>	<i>Digjitalizimi i periodikut</i>	<i>122,714 faqe</i>
		<i>Gjithsej</i>	<i>749, 427 faqe të digjitalizuara</i>

5. PROGRAMET AKADEMIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Një nga prioritetet strategjike të vitit 2025 ka qenë krijimi i programit akademik në Bibliotekari dhe Shkenca të Informacionit. Në kuadër të këtij objektiv janë zhvilluar një sërë aktivitete përgatitore, përfshirë takime me përfaqësues të Universitetit të Prishtinës, Këshillin Shtetëror të Cilësisë dhe Agjencinë e Akreditimit, si dhe janë bërë analiza të modeleve të akreditimit për programet BA dhe MA. Po ashtu, janë realizuar konsultime me universitete partnere ndërkombëtare, përfshirë Universitetin Humboldt, Universitetin e Zarës dhe Universitetin e Ljubljanës.

Si rezultat i këtyre angazhimeve, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe Universitetit të Prishtinës, me qëllim forcimin e bashkëpunimit edukativ dhe kulturor në fushën e arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit të programeve studimore baçelor dhe master në bibliotekari. Marrëveshja parasheh përfshirjen e personelit në ligjërim, hulumtim dhe projekte të përbashkëta, shkëmbimin e materialeve akademike, shfrytëzimin e infrastrukturës hapësinore, si dhe angazhimin e studentëve në aktivitete kërkimore dhe punë praktike.

Sipas marrëveshjes, Universiteti i Prishtinës obligohet të hartojë kurrikulën e programit studimor, të sigurojë personelin akademik adekuat dhe të ndërmarrë procedurat e akreditimit. Ndërkaq, Biblioteka Kombëtare e Kosovës do të ofrojë qasje në fondet dhe burimet bibliotekare për stafin dhe studentët e UP-së, do të mbështesë zhvillimin e programeve studimore, do të kontribuojë në projekte edukative dhe kërkimore të përbashkëta, si dhe do të ofrojë mundësi për punë praktike për studentët.



Figura 3. Lidhja e bashkëpunimit me UP-në

6. AKTIVITETET KULTURORE DHE PROGRAMET PUBLIKE

Gjatë vitit 2025, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka vijuar me organizimin e aktiviteteve tradicionale vjetore, duke ruajtur dhe forcuar rolin e saj si qendër kulturore dhe informuese me shtrirje kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të aktiviteteve ekspozuese dhe botuese, Biblioteka Kombëtare organizoi një sërë ekspozitash tematike, të fokusuara në tema të rëndësishme si pavarësia, poezia, libri dhe çlirimi, si në ambientet e saj ashtu edhe në bashkëpunim me institucione të tjera kombëtare dhe me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Të gjitha ekspozitat e realizuara gjatë vitit u bashkërenduan dhe u dokumentuan në mënyrë sistematike. Krahas tyre, u realizua botimi i katalogut "Thesare të Bibliotekës Kombëtare", si dhe katalogë shoqërues për ekspozitat, duke kontribuar në promovimin, dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë bibliotekare dhe kulturore.

6.1 Aktivitetet vjetore tradicionale

6.1.1. Java e Bibliotekës në Kosovë 2025

Java e Bibliotekës 2025 u zhvillua me karakter ndërkombëtar dhe përfshiu një program të pasur me sesione shkencore, panele diskutimi, ekspozita, aktivitete kulturore, ligjërata dhe shfaqje filmash, duke u shtrirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky edicion u karakterizua nga një frymë e fuqishme ndërkombëtare, falë pjesëmarrjes së përfaqësuesve nga bibliotekat kombëtare të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Bullgarisë dhe Turqisë.

Java nisi me hapjen e ekspozitës: Trashëgimia orientale në Kosovë: Dorëshkrimet orientale në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, e cila solli në vëmendje materiale të rralla nga fondi arkivor i BKK-së. Më tej, programi përfshiu panele diskutimi, si: e drejta e autorit në epokën digjitale, përkthimi letrar, si dhe një aktivitet të veçantë kushtuar Martin Camajit. Në kuadër të Javës u promovua edhe katalogu Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, një botim që prezanton vlerat e rralla të fondit dokumentar dhe arkivor të institucionit.

Në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës, përgjatë gjithë javës u organizuan shfaqje të gjashtë filmave vendorë me rëndësi artistike e historike, duke e lidhur bibliotekën me artet pamore dhe kinematografinë. Një element tejet domethënës i këtij edicioni ishte shtrirja e aktiviteteve në nivel kombëtar: biblioteka publike në qytetet kryesore të Kosovës organizuan ngjarje të ngjashme, duke e kthyer Javën e Bibliotekës në një festë të përbashkët të librit dhe dijes.



Figura 4. Disa aktivitete nga Java e Bibliotekës 2025

6.1.2. Dita e Bibliotekës 2025

Më 25 nëntor 2025 me një ceremoni solemne u shënua 81-vjetori i themelimit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Gjatë ceremonisë u prezantua projekti i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës, duke reflektuar bashkëpunimin, vizionin dhe procesin e migrimit të të dhënave në platformën e re Koha. U theksua përparimi i shpejtë në digjitalizim – një hap madhor drejt modernizimit të shërbimeve bibliotekare. Çmimi “Pjetër Bogdani” iu nda Dr. Sharon Yang për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në hartimin e rrjetit bibliotekar. Falë bashkëpunimit me Baletin Kombëtar të Kosovës, mbrëmja u pasurua nga një performancë elegante baleti, dhe u përmyll me hapjen e ekspozitës “Nga dorëshkrimi te digjitalja”, përmes së cilës vizitorët patën rastin të shohin nga afër libra të rrallë e të vjetër dhe t’i shfletojnë në kohë reale versionet e tyre të digjitalizuara.



Figura 5. Dita e Bibliotekës: 81-vjetori i themelimit të BKK-së

6.2 Ekspozita, aktivitete dhe botime

6.2.1. Pavarësia e Kosovës në shtypin shqiptar

Në kuadër të ceremonisë solemne të shënimit të 17-Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, u hap ekspozita “Pavarësia e Kosovës në shtypin shqiptar”, e organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”. Ekspozita pasqyroi shpalljen e Pavarësisë së Kosovës përmes pamjeve nga shtypi vendor dhe ndërkombëtar, duke dëshmuar rolin e medias në dokumentimin e kësaj ngjarjeje historike. Koncepti i ekspozitës përfshiu prezantimin e ballinave të gazetave të kohës, të shoqëruara me komente historike dhe materiale multimediale.



Figura 6. Ekspozita Pavarësia e Kosovës në shtypin shqiptar

6.2.2. Ekspozitë në nder të Epopesë së UÇK-së

Me rastin e shënimit të 27-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, në nderim të heroizmit dhe flijimit të komandantit Adem Jashari dhe familjes Jashari, u hap një ekspozitë kushtuar veprës heroike

dhe rënies së tyre. Në ekspozitë u paraqitën materiale nga fondi i Bibliotekës, përfshirë gazeta të periudhës dhjetor 1991 – mars 1998.



Figura 7. Ekspozita në nder të Epopesë së UÇK-së

6.2.3. Dita Botërore e Poezisë

Në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani” u shënuar Dita Botërore e Poezisë me një aktivitet letrar kushtuar promovimit të krijimtarisë poetike dhe nxitjes së leximit të rinjtë.



Figura 8. Shënimi i Ditës Botërore të Poezisë

6.2.4. Dita botërore e librit dhe e së drejtës së autorit

Me rastin e 23 Prillit – Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” hapi një ekspozitë me rreth 100 tituj librash të përzgjedhur nga fondet e saj, që përfshinë zhanre të ndryshme letrare. Ekspozita synoi promovimin e pasurisë letrare dhe kulturore të bibliotekës, si dhe nxitjen e interesimit për lexim dhe respektimin e të drejtave të autorëve.



Figura 9. Shënimi i Ditës botërore të librit dhe të së drejtës së autorit

6.2.5. Ekspozita Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie

Në nder të Ditës së Çlirimit të Kosovës, në Bibliotekën Kombëtare u hap ekspozita dokumentare “Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie”. Ekspozita, nën patronazhin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, u realizua në bashkëpunim mes Bibliotekës Kombëtare, Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, Agjencisë Shtetërore të Arkivave dhe Muzeut Kombëtar.

Përmes materialeve historike — libra, dokumente, kujtime, artikuj mediatikë, fotografi dhe artefakte — ekspozita pasqyron rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë. Gjatë aktivitetit u shfaq edhe një dokumentar me pamje nga lufta dhe reagime ndërkombëtare. Ekspozita shërben si dëshmi historike, thirrje për kujtesë kolektive dhe vlerësim të sakrificës për liri. Kjo ekspozitë, përpos në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, u hap edhe në ambientet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.



Figura 10. Çelja e ekspozitës Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie në BKK

Në kuadër të Javës Kulturore Kombëtare, ekspozita “Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie” u hap në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, në Qendrën “Sotir Kolea”.



Figura 11. Çelja e ekspozitës Nga lufta në liri: Çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie në BKSH

6.2.6. Ekspozitë në kuadër të Javës së Bibliotekës: Trashëgimia orientale në Kosovë: Dorëshkrimet orientale në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës

Për herë të parë në ekspozitën Trashëgimia orientale në Kosovë: Dorëshkrimet orientale në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës u ekspozuan rreth 30 vepra të rralla dhe me vlerë, prej të cilave 25 janë dorëshkrime autentike, ndërsa pesë janë libra të shtypur. Ky koleksion reflekton pasurinë e trashëgimisë sonë kulturore dhe shpirtërore, dhe përfaqëson një spektër të gjerë të dijeve tradicionale islame.



Figura 12. Ekspozita Trashëgimia orientale në Kosovë: Dorëshkrimet orientale në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës

6.2.7. Ekspozitë në kuadër të Ditës së Bibliotekës: Nga dorëshkrimi te digjitalja

Në kuadër të 81-vjetorit të themelimit të Bibliotekës Kombëtare, u hap ekspozita “Nga dorëshkrimi te digjitalja”, në kuadër të së cilës u ekspozuan libra të rrallë dhe të vjetër, të prezantuar krahas versioneve të tyre të digjitalizuara, të cilat mund të shfletoheshin për të lexuar më shumë.



Figura 13. Ekspozita Nga dorëshkrimi te digjitalja

6.2.8. Ekspozitë dokumentare dhe forum me temë Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ) në bashkëpunim me Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë

Më 12 maj 2025, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës u mbajt forumi “Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ)”, në bashkëpunim me Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL). Ngjarja shënoi hapjen e kolanës “Zá n’Kujtesë”, një platformë periodike e IKKL-së për ndërngjegjësime, dokumentim dhe drejtësi historike.

Ngjarja përfundoi me hapjen e ekspozitës dokumentare “Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ)”, e cila paraqet jetët dhe historitë e tyre përmes portreteve, letrave, dokumenteve ushtarake dhe certifikatave të vdekjes, duke theksuar rëndësinë e kujtesës dhe dinjitetit njerëzor.



Figura 14. Pamje nga ekspozita dhe forumi në bashkëpunim me IKKL-në Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ)

6.2.9. Shënimi i Ditës së autorëve evropianë



Nën moton “Read for Real”, desku i Evropës Kreative, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare, organizoi aktivitete të dedikuara lexuesve të vegjël dhe promovimit të kulturës së leximit.

Figura 4. Shënimi i Ditës së autorëve evropianë

6.2.9 Botimi i kompletit *Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe*

Kompleti prej dhjetë vëllimesh "Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe" iu dorëzua dje familjarëve të të mbijetuarve dhe dëshmitarëve të masakrës. Pranë Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe, u mbajt ceremonia e dorëzimit të kompletit prej dhjetë vëllimesh "Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe", që përmban mbi 200 dëshmi autentike të mbledhura nga të mbijetuarit dhe dëshmitarët e kësaj tragjedie të vitit 1999. Këto botime, të dokumentuara me përkushtim dhe ndjeshmëri, u janë dorëzuar vetë atyre që i dhanë zë dhimbjes dhe kujtesës kolektive si një akt nderimi dhe kujtese për dhimbjen dhe qëndresën që kanë përjetuar. Nëpërmjet fjalës së shkruar, këto rrëfime janë kthyer në një dokument historik që do të mbetet për brezat e ardhshëm.



Figura 5. Dhurimi i kompletit të vëllimeve Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe për Muzeun e Masakrës

6.2.10. Botimi i katalogut "Thesare të Bibliotekës Kombëtare"

Gjatë këtij viti, në kuadër të Javës së Bibliotekës 2025, u botua katalogu "Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës". Katalogu përfshin një për zgjedhje librash dhe dorëshkrimesh historike që datojnë nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XX, duke pasqyruar vepra me rëndësi të veçantë historike, kulturore dhe gjuhësore për trashëgiminë shqiptare. Publikimi u promovua gjatë "Javës së Bibliotekës në Kosovë", si pjesë përbërëse e ekspozitës me të njëjtin emër, e cila kishte për qëllim ekspozimin e materialeve më të çmuara të koleksionit të bibliotekës, përfshirë libra të rrallë, dorëshkrime, harta, fotografi dhe materiale të tjera arkivore. Ndër eksponatet e paraqitura ishte edhe vepra më e vjetër e ruajtur në fondet e bibliotekës, një botim i vitit 1533.



Figura 6. Katalogu Thesare të Bibliotekës Kombëtare

6.2.11. Katalogët shoqërues të aktiviteteve dhe ekspozitave

6.2.10.1. Autorët nga Kosova

Ky katalog, në *Panairin e Librit në Leipzig 2025*, paraqet një për zgjedhje të autorëve shqiptarë nga Kosova, të cilët përfaqësojnë breza dhe gjini të ndryshme letrare, nga poezia dhe proza të studimet letrare dhe dramaturgjia. Autorët e përfshirë në këtë katalog vijnë nga Kosova dhe

diaspora, duke pasuruar mozaikun e letërsisë shqipe me perspektiva të ndryshme artistike dhe tema universale. Veprat e tyre eksplorojnë historinë, kujtesën, identitetin, përvojën e migrimit, dashurinë, sfidat shoqërore dhe filozofinë e ekzistencës, duke ofruar një pasqyrim të gjerë të realitetit të Kosovës ndër vite.

6.2.10.2. *Katalog i titujve të ekspozuar në Panairin e Librit në Leipzig*

Katalog i veçantë me rreth 100 tituj librash dhe revistash nga zhanre të ndryshme si poezi, prozë, dramë, studime letrare dhe kulturore. Në katalog përfshihen edhe botime të përkthyer në gjuhë të huaja, duke synuar për hapjen e letërsisë shqipe të Kosovës në skenën ndërkombëtare.

6.2.10.3. *Nga lufta në liri: çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie*

Katalogu *Nga lufta në liri: çlirimi i Kosovës në dokumente, kujtime dhe medie* paraqet përpjekjen e përbashkët ndër institucionale për ta dëshmuar rrugëtimin e popullit të Kosovës nga pushtimi në çlirim përmes zërit të doku mentit, kujtesës dhe dëshmisë vizuale. Ky katalog është rezultat i bashkëpunimit ndërinstitutional midis Bibliotekës Kombëtare, Agjencisë Shtetërore të Arkivave, Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës dhe Muzeut Kombëtar të Kosovës.

6.2.10.4. *Katalog i dorëshkrimeve orientale*

Ky katalog paraqet një përzgjedhje të veçantë nga një prej fondeve më të rëndësishme që ruhen në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës - Koleksioni i Dorëshkrimeve Orientale.

6.2.10.5. *Katalog "Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë (RSFJ)"*

Katalogu i botuar nga Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", shërben si dokumentim i ekspozitës "*Ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën e ish-Jugosllavisë*". Ai prezanton dëshmi, kujtime dhe materiale arkivore që pasqyrojnë historinë e ushtarëve shqiptarë gjatë konfliktit dhe synon të ruajë kujtesën historike për brezat e ardhshëm.

7. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE DIPLOMACIA KULTURORE

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe diplomacia kulturore kanë mbetur ndër prioritetet strategjike të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës (BKK), duke promovuar historinë, kulturën dhe letërsinë e vendit në arenën globale dhe duke krijuar mundësi të reja për shkëmbim profesional dhe krijim lidhjesh ndërinstitutionale. Gjatë vitit të raportuar, BKK intensifikoi pjesëmarrjen në ngjarje ndërkombëtare, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi dhe zhvilloi iniciativa të rëndësishme diplomatike kulturore.

7.1. Panairi i librit në Leipzig

Biblioteka Kombëtare e Kosovës përfaqësoi vendin në Panairin e Librit në Leipzig, një nga ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare të botës së librit, i dyti më i madh në Gjermani, i mbajtur këtë vit nën moton "*Fjalët lëvizin botët*", që thekson fuqinë e letërsisë për të ndikuar dhe ndryshuar shoqëritë.

Në kuadër të programit *Leipzig Liest*, Biblioteka Kombëtare organizoi disa ngjarje letrare me pjesëmarrjen e autorëve dhe përkthyesve nga Kosova: *Letërsia nga Kosova* solli në fokus autorin dhe përkthyesin Qerim Ondozi dhe botuesen Feride Berisha, duke diskutuar mbi letërsinë bashkëkohore shqiptare dhe sfidat e përkthimit; *Kujtesa individuale dhe kolektive*, me autorin Ag Apolloni, trajtoi rolin e shkrimtarit si urë mes kujtesës individuale dhe kolektive, duke përfshirë librin e tij të përkthyer në anglisht *Red Riding Hood: Fairy Tale for Grown-Ups*, që reflekton fuqinë e letërsisë për të ruajtur memorien kolektive të luftës. *Gjuha, migrimi dhe letërsia në Kosovë*, i organizuar bashkë me TRADUKI, solli diskutime mbi sfidat e letërsisë bashkëkohore kosovare në kontekstin e përvojave traumatike, arratisjes dhe migrimit, me pjesëmarrjen e drejtoreshës Blerina Rogova Gaxha dhe shkrimtares Jehona Kicaj.



Figura 7. Stenda e Kosovës dhe ngjarjet letrare të BKK-së në Panairin e Librit në Leipzig



Figura 8. Nga takimi me drejtoreshën e Panairit të Leipzigut, znj. Astrid Böhmisch

7.2. Lobimi dhe anëtarësimi në TRADUKI

Gjatë qëndrimit në Leipzig u zhvillua komunikim intensiv me rrjetin letrar Traduki, përkatësisht me drejtoreshën znj. Angelika Salvisberg, lidhur me procesin e anëtarësimit të Kosovës në rrjetin Traduki. Paralelisht, BKK vijoi bashkëpunimi me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Gjermani, si dhe u zhvillua komunikim me ambasadorin z. Faruk Ajeti për mbështetjen institucionale të këtij procesi.

Në kuadër të qëndrimit në Leipzig, gjatë Panairit të Librit, u mbajtën disa takime pune, përfshirë takimin në TRADUKI, ku drejtoresha, znj. Blerina Rogova Gaxha dhe anëtarja e Këshillit Drejtues të BKK-së, znj. Ervina Halili u takuan me drejtoreshën e TRADUKI-t, Angelika Salvisberg dhe znj. Antje Contius. Gjithashtu, u realizua takim me Zyrën e Jashtme gjermane, me z. Steffan Rossel, lidhur me çështjet e anëtarësimit të Kosovës në rrjetin letrar Traduki.

Komunikimi dhe angazhimi në lidhje me këtë çështje ka vazhduar përgjatë gjithë vitit 2025.

7.3. Bashkëpunimi me Bibliotekën e Kongresit përmes programit të shkëmbimit të materialeve bibliotekare (DMEP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës nisi bashkëpunim me Bibliotekën e Kongresit në SHBA përmes programit ndërkombëtar të shkëmbimit të materialeve, *Duplicate Materials Exchange Program (DMEP)*. Ky bashkëpunim mundëson shkëmbimin e librave, monografive dhe revistave, me fokus në shkencat shoqërore. Në takimin e 5 shkurtit 2025, përfaqësuesit e të dy institucioneve u dakorduan për fillimin e programit me përzgjedhjen e materialeve të para për shkëmbim. Biblioteka e Kongresit shprehu interes të veçantë për krijimin e një koleksioni të dedikuar për Kosovën, duke kontribuar në rritjen e qasjes ndërkombëtare në botimet, kulturën dhe trashëgiminë intelektuale të vendit.



Figura 9. Materialet e shkëmbyera mes BKK-së dhe Bibliotekës së Kongresit

7.4. Kongresi Botëror i Bibliotekave dhe Informacionit IFLA 2025 – (Astana)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës mori pjesë në Kongresin e 89-të Botëror të Bibliotekave dhe Informacionit (IFLA), të mbajtur në Astana, Kazakistan, me pjesëmarrjen e mbi 1,300 delegatëve nga 140 vende. Kongresi shërbeu si platformë e rëndësishme për shkëmbim përvojash dhe forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Drejtoresha e BKK-së, Dr. Blerina Rogova Gaxha, prezantoi kumtesën “Rebuilding memory through digital collecting: The case of the National Library of Kosovo”, ku u theksuan projektet e digjitalizimit të bibliotekës dhe ato të ruajtjes së kujtesës kombëtare. Në kuadër të kongresit u zhvilluan edhe takime me lidhshimin e IFLA-s dhe drejtues të bibliotekave kombëtare nga vende të ndryshme, si dhe u mor pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të IFLA-s, duke përforcuar angazhimin e Kosovës në dialogun global për të ardhmen e bibliotekave dhe informacionit.



Figura 10. BKK në Kongresin Botëror të Bibliotekave dhe Informacionit në Astana, Kazakistan

7.5. Konferenca e drejtorëve të bibliotekave kombëtare të Evropës juglindore (Shkup)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” mori pjesë më 29–30 shtator në takimin e 12-të vjetor të drejtorëve të Bibliotekave Kombëtare të Evropës Juglindore, të mbajtur në Shkup, nën temën “Strategjia rajonale për inteligjencën artificiale”, me pjesëmarrjen e drejtoreshës së përgjithshme, Dr. Blerina Rogova Gaxha. Takimi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe rolit të inteligjencës artificiale në zhvillimin e shërbimeve bibliotekare. Në kuadër të tij u prezantua edhe Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Trashëgiminë Kulturore, ku Kosova kontribuoi aktivisht në diskutimet mbi ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e trashëgimisë kulturore. U bë gjithashtu e ditur se organizimi i kësaj konference në vitin 2026 do të bëhet nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës.



Figura 11. Takimi mes drejtorëve të bibliotekave kombëtare të Evropës juglindore dhe pjesëmarrja në konferencën e parë ndërkombëtare për Trashëgiminë kulturore në Shkup, Maqedoni e Veriut

7.6. Vizitat zyrtare

7.6.1. Sofje (Hapja e Këndit të Librit të Kosovës në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë)

Në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë “Shën Kirili dhe Metodi” u përurua Këndi i Librit të Republikës së Kosovës, si pjesë e programit për promovimin e letërsive kombëtare dhe forcimin e diplomacisë kulturore. Ky kënd, i 36-ti me radhë, do të shërbejë si hapësirë e përhershme me botime të autorëve shqiptarë dhe vepra mbi historinë e kulturën shqiptare. Me këtë rast u zhvillua edhe një takim zyrtar ndërmjet drejtuesve të dy bibliotekave kombëtare dhe përfaqësuesve diplomatikë, ku u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit profesional dhe kulturor ndërmjet institucioneve.



Figura 12. Vizita zyrtare në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë

7.6.2. Paris (Vizitë në Bibliotekën Kombëtare të Francës)

Me ftesë të Bibliotekës Kombëtare të Francës, drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, znj. Blerina Rogova Gaxha, zhvilloi një takim zyrtar në Paris me përfaqësues të këtij institucioni, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional. Në takim u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit kulturor, shkëmbimi i praktikave të mira në menaxhimin bibliotekar dhe realizimi i projekteve të përbashkëta, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e bibliotekarisë.



Figura 13. Vizita zyrtare në Bibliotekën Kombëtare të Francës

7.7. Erasmus+ dhe TAIEX: Zhvillimi i kapaciteteve të stafit

Gjatë këtij viti, Biblioteka Kombëtare ka vazhduar përgatitjen dhe komunikimin aktiv për përfshirjen në programin Erasmus+. Janë zhvilluar takime me Zyrën Erasmus në Kosovë për të diskutuar mundësitë e përfshirjes së stafit në shkëmbime dhe vizita studimore. Përmes këtij programi, stafi i Bibliotekës do të ketë mundësinë për të ndjekur trajnime dhe programe bashkëpunimi në bibliotekat partnere, duke kontribuar në zhvillimin profesional dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.

Në kuadër të programit TAIEX, Biblioteka Kombëtare ka vijuar përgatitjet për dërgimin e një punonjëseje për trajnim në Bibliotekën Kombëtare të Francës. Ky trajnim do të sigurojë përvojë të drejtpërdrejtë dhe praktikë profesionale, duke fuqizuar kapacitetet e stafit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të institucioneve bibliotekare.

8. MARRËVESHJET DHE BASHKËPUNIMET KOMBËTARE NDËRINSTITUCIONALE

Gjatë vitit, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka avancuar jo vetëm bashkëpunimet ndërkombëtare, por edhe ato kombëtare, duke forcuar rrjetin institucional dhe shkëmbimin profesional. Në këtë kuadër, BKK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të rëndësishme vendore:

8.1. Marrëveshje me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës

BKK nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit institucional. Prioritet i veçantë i marrëveshjes është digjitalizimi i plotë i fondit të gazetës *Rilindja*, një nga pasuritë më të çmuara të trashëgimisë dokumentare të Kosovës. Marrëveshja gjithashtu synon të nxisë bashkëpunimin në



shkëmbimin e koleksioneve, informacionit bibliografik, njohurive teknike dhe teknologjike, si dhe në aktivitete kulturore dhe shkencore.

Figura 14. Nënshkrimi i marrëveshjes me u.d. Drejtorin e ASHAK, z. Mehmed Xhemajli

8.2. Marrëveshje me Institutin e Historisë "Ali Hadri"



Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i lidhjes institucionale në fushat e historisë, trashëgimisë kulturore dhe shkencës, përmes këmbimit të literaturës profesionale dhe shkencore, bashkëpunimit në projekte shkencore e kulturore, promovimit dhe prezantimit të veprave historike dhe kulturore, organizimit të aktiviteteve dhe ekspozitave të përbashkëta, si dhe mbështetjes për studiues, studentë, nxënës dhe institucionet arsimore e kulturore.

Figura 15. Nënshkrimi i marrëveshjes me drejtoreshën e Institutit të Historisë, znj. Teuta Shala Peli

8.3. Marrëveshje me Universitetin e Prishtinës



Marrëveshja e nënshkruar mes UP-së dhe BKK-së, ka për qëllim bashkëpunimin edukativ dhe kulturor në fushën e arsimit, hulumtimit, krijimit të programit studimor baçelor dhe programit Master në fushën e bibliotekarisë, aftësimit profesional të studentëve të Universitetit të Prishtinës në fushat që lidhen me bibliotekari dhe fushat e tjera të interesit të përbashkët dhe në çdo veprimtari tjetër të interesit dypalësh, si dhe angazhimin e praktikantëve në BKK.

Figura 16. Nënshkrimi i marrëveshjes me rektorin e Universitetit të Prishtinës, z. Arben Hajrullahu

8.4. Marrëveshje me Fakultetin Filozofik

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Shoqatës së Filozofëve të Kosovës, dhe Fakultetit Filozofik përtë zgjeruar bashkëpunimin mes institucioneve.

8.5. Marrëveshje bashkëpunimi MKRS – IKKL – BKK – MZK – UP

Në kuadër të projektit për dokumentimin e 10 masakrave në Kosovë, u nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit mes MKRS-së, IKKL-së, BKK-së, MZK-së dhe UP-së.

8.6. Marrëveshje me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë



Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë nënshkruan më 21.11.2025 një marrëveshje bashkëpunimi në qendrën "Sotir Kolea" me synim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fushën e kulturës, dijës dhe trashëgimisë.

Figura 17. Nënshkrimi i marrëveshjes me drejtorin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, z. Piro Misha

8.7. Bashkëpunimi me Filharmoninë e Kosovës



Për të shënuar hapjen solemne të Javës së Bibliotekës, Filharmonia e Kosovës ofroi një performancë të veçantë nga një kuartet, për të gjithë të pranishmit.

Figura 18. Performanca e Filharmonisë së Kosovës në hapjen solemne të Javës së Bibliotekës 2025


8.8. Bashkëpunimi me Baletin Kombëtar të Kosovës



Për të shënuar hapjen solemne të Ditës së Bibliotekës, Baleti i Kosovës ofroi një performancë të veçantë për të gjithë të pranishmit.

Figura 19. Performanca e Baletit të Kosovës në ceremoninë e Ditës së Bibliotekës 2025

8.9. Bashkëpunimi me Qendrën Kinematografike të Kosovës



Në kuadër të Javës së Bibliotekës, falë bashkëpunimit me QKK-në, gjatë gjithë javës në amfiteatrin e vogël të BKK-së u shfaqën gjashtë filma.

Figura 20. Shfaqja e filmit "Zgjoi" në amfiteatrin e vogël të BKK-së

8.10. Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Në kuadër të bashkëpunimit me MKRS në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, u promovua libri “Një kosovar si Radomiri - Radomir Dimiq, përmbledhje shkrimesh”. Ky libër, që mblidhet në një testament të guximit, të vërtetës dhe të shpirtit të pathyeshëm, përmbledh shkrimet dhe intervistat e gazetarit Radomir Dimiq, të botuara ndër vite në mediet e vendit.

Figura 21. Promovimi i librit të Radomir Dimiq në BKK



Gjithashtu, në bashkëpunim me MKRS-në dhe Teatrin Kombëtar u mbajt ceremonia përkujtimore për 80-vjetorin e lindjes së Jusuf Gërvallës. Ngjarja përfshiu interpretime artistike të poezive të Gërvallës nga aktorë dhe artistë të njohur, fjalime për trashëgiminë e tij kulturore, si dhe një performancë muzikore në nder të tij. Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, gjithashtu, ka pranuar një piano të re, dhuratë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në kuadër të nismës për fuqizimin e jetës kulturore e artistike në vend.

Figura 22. Dhurimi i pianos nga MKRS-ja për BKK-në

8.9. Takim me drejtorin e institutit Yunus Emre



Në kuadër të takimit të realizuar me drejtorin e institutit Yunus Emre, z. Ramazan Yilmaz, u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjes për digjitalizimin e dorëshkrimeve orientale, si dhe për trajnimin e stafit në Turqi në fushën e restaurimit. Po ashtu, u shqyrtua organizimi i trajnimeve në Kosovë nga ekspertë të ardhur nga Turqia. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe bashkëpunimit në aktivitete kulturore, përfshirë organizimin e tyre në amfiteatrin e vogël të bibliotekës, si dhe zhvillimit të ngjarjeve letrare me pjesëmarrjen e poetëve dhe aktorëve nga Turqia.

Figura 23. Takim me drejtorin e Institutit Yunus Emre, z. Ramazan Yilmaz

8.10. Takim me KFOR-in Italian



Një takim miqësor mes drejtoreshës së Bibliotekës Kombëtare dhe përfaqësuesve të njësisë italiane të KFOR-it. Gjatë takimit u diskutua mbi punën aktuale të Bibliotekës, sfidat dhe prioritetet e saj, si dhe mundësitë për bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Figura 24. Takimi me KFOR-in italian

8.11. Takim me përfaqësues nga diaspora



Gjatë vitit, Biblioteka Kombëtare pati takime me përfaqësues të diasporës, në kuadër të aktiviteteve kushtuar diasporës “Ditët e Diasporës”. Këto iniciativa synuan forcimin e lidhjes me komunitetin jashtë vendit dhe promovimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të Bibliotekës për publikun jashtë kufijve.

Figura 25. Takimi me përfaqësues nga diaspora në BKK

9. MENAXHIMI INSTITUCIONAL

Gjatë vitit 2025, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka funksionuar në bazë të një menaxhimi të rregullt institucional dhe bashkëpunimi të ngushtë me Këshillin Drejtues. Veprimtaria institucionale e saj zhvillohet mbi dy shtylla kryesore të funksionimit institucional profesional: Departamentin e Zhvillimit dhe Përpunimit të Koleksioneve dhe Departamentin e Shërbimit për Përdorues dhe Zhvillimit Profesional. Këto dy departamente përbëjnë boshtin themelor të veprimtarisë së BKK-së, duke bërë mbledhjen, përpunimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, promovimin e saj dhe ofrimin e shërbimeve bibliotekare dhe qasjes efektive për përdoruesit.

9.1. PASURIMI DHE ZHVILLIMI I KOLEKSIONEVE

Në kuadër Departamentit të Zhvillimit dhe Përpunimit të Koleksioneve zhvillohen proceset themelore që lidhen me pasurimin, përpunimin bibliografik, kontrollin e cilësisë së të dhënave, ruajtjen e trashëgimisë dokumentare, si dhe transformimin digjital të koleksioneve bibliotekare. Aktivitetet e këtij departamenti ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve për përdoruesit, në funksionimin e katalogut kombëtar, në përmbushjen e detyrimeve ligjore të institucionit dhe në ruajtjen afatgjatë të trashëgimisë kulturore të shkruar.

Në kuadër të Takimit Rajonal të ISBN-së dhe ISMN-së, të mbajtur më 10–11 qershor 2025 në Zagreb, nga BKK morën pjesë dy punonjëset e njësive përkatëse, Lavdie Mani dhe Edona Munishi Kokollari, të cilat kontribuan në diskutimet mbi zhvillimet e reja në menaxhimin e ISBN/ISMN dhe shkëmbyen përvoja profesionale.



Figura 26. BKK në takimin Rajonal të ISBN-së dhe ISMN-së

9.1.1. Pasurimi

Gjatë këtij viti, fondi bibliotekar i Bibliotekës Kombëtare është pasuruar përmes të gjitha formave të parashikuara: ekzemplarit të detyrueshëm, blerjeve, dhuratave dhe shkëmbimeve, duke pranuar gjithsej 1.836 tituj dhe 8.453 ekzemplarë, përfshirë 81 revista dhe 9 punime doktrature. Procesi i blerjes është realizuar përmes dy procedurave të ndara gjatë vitit: blerja e parë më 13.08.2025, me 262 tituj, dhe blerja e dytë më 02.12.2025, me 242 tituj. Përzgjedhja e titujve është bërë në bazë të hulumtimit profesional, nevojave të fondit dhe prioriteteve tematike, duke synuar pasurimin sa më cilësor të koleksioneve.

Janë përpunuar 1.625 tituj, ndërsa njësitë bibliografike më pas janë migruar me sukses në sistemin e ri të integruar, duke ruajtur cilësinë dhe integritetin e të dhënave.

Gjithashtu, gjatë vitit janë inventarizuar mijëra njësi fizike dhe janë ndarë 5.714 kopje arkivore, si dhe janë përgatitur 86 lista për katalogim (1.720 tituj). Procesi i menaxhimit të materialeve tepriçë, veçanërisht botimet e shtëpisë "Rilindja", është zhvilluar sipas planit, dhe shpërndarja e plotë pritet të përfundojë në janar 2026. Më poshtë janë paraqitur të dhënat në formë tabelare:

Tabela 4. Paraqitja e formave të pasurimit të fondit bibliotekar

Nr	Forma e pasurimit	Tituj	Ekzemplarë
1	<i>Ekzemplar i detyrueshëm</i>	1,579	7,895
2	<i>Dhurata</i>	257	558
3	<i>Revista</i>	81	369
4	<i>Punime doktrature</i>	9	9
5	<i>Blerje – 13.08.2025</i>	262	—
6	<i>Blerje – 02.12.2025</i>	242	—
Gjithsej		2,340	8,453

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për depozitimin e botimeve, për çdo botim që hidhet në treg është e detyrueshme dorëzimi i pesë (5) ekzemplarëve në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani". Ky obligim u takon autorëve dhe botuesve që publikojnë libra, revista apo materiale të tjera botuese.

Zbatimi i këtij detyrimi përbën një praktikë thelbësore për ruajtjen, dokumentimin dhe pasurimin e trashëgimisë kulturore dhe bibliografike të Republikës së Kosovës.

Për shkak të mosrespektimit të këtij obligimi ligjor, gjatë periudhës raportuese është inicuar lëndë gjyqësore ndaj shtëpisë botuese "Buzuku", përmes Zyrës Ligjore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).

9.1.2. Katalogimi

Gjatë vitit 2025, përpunimi bibliografik dhe kontrolli i cilësisë janë zhvilluar në kushte të veçanta teknike për shkak të mosfunksionimit të sistemit ALEPH 500, çka ka kërkuar përdorimin e procedurave alternative për evidentimin dhe regjistrimin e materialeve. Përmes formularëve ndihmës në Excel është siguruar vazhdimësia e punës për materialet aktuale dhe retrospektive, në përputhje me standardet ndërkombëtare të katalogimit, duke shërbyer njëkohësisht si përgatitje për migrimin e të dhënave në sistemin e ri të integruar bibliotekar.

Katalogimi në Botim (CIP) ka përbërë një segment të rëndësishëm të këtij procesi, me gjithsej 2,437 njësi të përpunuara, kryesisht libra në gjuhën shqipe, të klasifikuara sipas KDU-së, me dominim të botimeve nga fusha e shkencave shoqërore.

9.1.3. Bibliografia

Gjatë vitit raportues, një komponent me rëndësi të veçantë i përpunimit bibliografik ka qenë puna në projektin afatgjatë për hartimin e Bibliografisë së librit shqip (1912–1999) në ish-Jugosllavi, e cila ka përfshirë hulumtime, verifikime dhe redaktime të thelluara të mijëra njësisive bibliografike. Ky proces ka kontribuar drejtpërdrejt në standardizimin e të dhënave dhe në pasurimin e memories bibliografike kombëtare, duke u zhvilluar paralelisht me detyrat e përditshme operative.

Kontrolli i cilësisë është realizuar në përputhje me standardet ISBD dhe KDU, duke siguruar koherencë dhe saktësi të regjistrimeve, edhe në kushte të kufizimeve teknike. Procesi është mbështetur nga trajnime profesionale dhe bashkëpunim ndërdivizional, të cilat kanë forcuar kapacitetet e stafit, kanë unifikuar praktikat e punës dhe kanë mundësuar përgatitjen e të dhënave për integrim në sistemin e ri të integruar bibliotekar.

9.1.4. Koleksionet e Veçanta

Gjatë vitit 2025, puna me koleksionet e veçanta të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është fokusuar në përpunimin bibliografik, dokumentimin dhe krijimin e kushteve për qasje të kontrolluar, duke theksuar rolin e tyre në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbështetjen e kërkimit shkencor. Vëmendje e veçantë i është kushtuar koleksionit fotografik, ku janë përpunuar 31 njësi nga koleksioni “Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008”, në përputhje me standardet profesionale dhe praktikat MARC21.

Paralelisht me përpunimin praktik, është punuar në hartimin e dokumenteve të brendshme për standardizimin e procesit, përfshirë formularët për pranimin e materialeve dhe verifikimin e të dhënave. Dokumentet janë si vijon: Drafti i Planit Strategjik të Pasurimit të Koleksionit Fotografik, i cili përcakton prioritetet tematike, kriteret e përzgjedhjes, formatet e pranueshme dhe objektivat afatgjata të pasurimit; Projekti për Menaxhimin e Koleksionit Fotografik, i orientuar drejt krijimit të një sistemi të integruar që përfshin mbledhjen, dokumentimin, katalogimin, digjitalizimin dhe ruajtjen afatgjatë të materialeve; Draft-projekti për Bashkëpunim Institucional, i cili synon ndërtimin e një rrjeti bashkëpunimi me institucione publike, organizata kulturore dhe koleksionues privatë, për mbledhjen dhe promovimin e trashëgimisë vizuale.

Gjithashtu, është trajtuar edhe koleksioni i artit grafik, me identifikimin dhe inventarizimin e 86 njësive dhe dokumentimin e plotë të 7 prej tyre, pavarësisht sfidave që lidhen me mungesën e të dhënave mbi autorësinë dhe origjinën. Të gjitha këto aktivitete kanë shërbyer si fazë përgatitore për digjitalizimin e koleksioneve të veçanta, duke krijuar bazën e nevojshme për qasje të qëndrueshme dhe transformim digjital të planifikuar.

9.2. SHËRBIMI PËR PËRDORUES DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Në kuadër të Departamentit të Shërbimit për Përdorues dhe Zhvillimit Profesional janë realizuar një sërë detyrash dhe aktiviteteve të vazhdueshme që lidhen drejtpërdrejt me shërbimin ndaj përdoruesve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, modernizimit të shërbimeve, zhvillimin profesional, menaxhimin e hapësirave të shërbimit dhe përmirësimin e kushteve të punës.

9.2.1. Shërbimi për Përdorues

Gjatë periudhës raportuese, nga Divizioni i Shërbimit për Përdorues janë ofruar shërbime të vazhdueshme me libra, gazeta dhe revista, si dhe janë evidentuar tregues të qartë të rritjes së përdorimit të shërbimeve bibliotekare.

Tabela 5. Përmbledhje e shërbimeve bibliotekare dhe numrit të përdoruesve

Nr.	Fusha	Përshkrimi i aktivitetit	Treguesit
1	Shërbime me libra	Porosi, rezervime, huazime dhe shkarkime librash	234 porosi librash; 609 libra të rezervuar; 329 libra të marrë për lexim; 240 libra të shkarkuar; 32 raste mungese; 1 rast dëmtimi
2	Shërbime me gazeta	Porosi, rezervime dhe shkarkime gazetash	1,783 porosi gazetash; 1,936 gazeta të rezervuara; 1,706 gazeta të shkarkuara; 22 raste mungese
3	Shërbime me revista	Porosi, rezervime dhe shkarkime revistash	1,409 porosi revistash; 1,660 revista të rezervuara; 1,235 revista të shkarkuara; 1 rast mungese
4	Anëtarësimi	Regjistrimi i anëtarëve të rinj dhe vazhdimi i kartelave	131 anëtarë me pagesë; 7 të liruar nga pagesa
5	Përdorimi i hapësirave	Lexues në salla të leximit dhe te periodiku	8,872 lexues

9.2.2. Depotë dhe koleksionet bibliotekare

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e këtij divizioni është shtrirë në detyrat që lidhen me menaxhimin dhe funksionimin e depove të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Janë zbatuar politikat e

divizionit për menaxhimin e depove, është ushtruar mbikëqyrje e vazhdueshme e hapësirave, e stafit dhe e vizitorëve në depo, si dhe është realizuar shkarkimi dhe barazimi i materialeve të porositura nga lexuesit dhe stafi i BKK-së.

9.2.3. Aftësimi dhe zhvillimi profesional

Përgjatë kësaj periudhe kohore ky divizion ka qenë i angazhuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave statistikore, koordinimin e thirrjeve për projekte dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Fokus i veçantë i është kushtuar hartimit dhe përmirësimit të formularëve për trajnime, raportime vjetore dhe projekte specifike, si dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me bibliotekat komunale, shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë. Paralelisht, divizioni ka realizuar projekte kulturore dhe profesionale, përfshirë riorganizimin e Fondit të Arteve Bashkëkohore, ekspozitën “Arti në 7000 Zëra” dhe ofrimin e shërbimeve profesionale informative për përdoruesit.



Figura 27. Biblioteka e Artit Bashkëkohor para dhe pas riorganizimit të fondit

Tabela 6. Përmbledhje e punëve të Divizionit të Aftësimit dhe Zhvillimit Profesional

Nr	Aktiviteti	Përshkrimi	Tregues / rezultate
1	Trajnime dhe zhvillim profesional	Hartimi dhe monitorimi i formularëve të trajnimit; Zhvillimi i ideve për trajnime në fushën e TI; Përgatitja e formularëve për raportime vjetore dhe projekte specifike	Formularë të rinj dhe të përmirësuar për staf dhe biblioteka
2	Të dhëna statistikore	Mbledhja e të dhënave statistikore për vitin 2024; Komunikimi dhe koordinimi me bibliotekat komunale	Raportim i konsoliduar statistikor
3	Thirrje për projekte	Hapja dhe administrimi i thirrjeve për individë dhe OJQ për vitin 2025;	Thirrje e realizuar sipas procedurave
4	Monitorimi i projekteve	Monitorim i 8 projekteve të OJQ-ve përmes emailit, telefonit dhe vizitave në terren; Hartim raportesh monitoruese	Monitorim në tri nivele; raporte dhe procesverbale
5	Raportime financiare	Finalizimi i raporteve për thirrjet 2023–2024; Proces raportimi në vazhdim për vitin 2025	Raporte profesionale dhe financiare
6	Projekte kulturore	Riorganizimi i Fondit të Arteve Bashkëkohore; Identifikimi dhe transliterimi i materialeve	Fond i riorganizuar dhe në proces integrimi

7	<i>Punë shtesë në fond</i>	<i>Identifikimi i 1,200 titujve pa signaturë dhe përgatitja për integrim</i>	<i>Proces i realizuar</i>
---	----------------------------	--	---------------------------

9.2.4. Biblioteka Digjitale

Gjatë vitit 2025, digjitalizimi është realizuar nga stafi i Divizionit të Bibliotekës Digjitale në muajt janar, shkurt, maj, qershor dhe korrik. Procesi është ndërprerë përkohësisht në mars dhe prill për shkak të mungesës së internetit dhe nga gushti deri në tetor për shkak të problemeve me serverin. Që nga tetori, procesi i digjitalizimit vazhdoi nga kompania e kontraktuar për projektin - Digjitalizimi i materialeve bibliotekare në Bibliotekën Kombëtare. Procesi i digjitalizimit të koleksioneve para kontraktimit të kompanisë është zhvilluar me një ritëm konstant, por më të ngadalshëm. Më poshtë paraqiten të dhënat realizuar nga stafi i Bibliotekës Digjitale:

Tabela 7. Përmbledhje e punëve të Bibliotekës Digjitale

<i>Nr</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Rezultati</i>
1	<i>Digjitalizimi i njësive fizike</i>	<i>Digjitalizim i librave, gazetave dhe revistave</i>	<i>109,544 objekte digjitale</i>
2	<i>Procesi OCR</i>	<i>Transliterim, crop, deskew dhe përpunim teknik</i>	<i>37,764 objekte digjitale</i>
3	<i>Ngarkimi në platformë</i>	<i>Ngarkimi i materialeve në Bibliotekën Digjitale</i>	<i>34,643 gazeta</i>
4	<i>Krijimi i meta-datave</i>	<i>Përshkrim dhe strukturim i të dhënave</i>	<i>2,012 objekte digjitale</i>

9.2.4.1. Projekti i ASHI-së

Në kuadër të projektit të ASHI-së për integrimin e zyrtarëve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në domain-in qeveritar, gjatë vitit 2025 janë realizuar një sërë aktivitetesh teknike që kanë përfshirë pajisjen me emaila zyrtarë të të gjithë punonjësve të BKK-së, konfigurimin e pajisjeve, instalimin e softuerëve, bartjen e të dhënave dhe ofrimin e ndihmës teknike për përdoruesit. Procesi ka vijuar në mënyrë të planifikuar, ndërsa disa raste mbeten në proces për shkak të ndërrimit të pajisjeve, pushimeve vjetore ose kthimit të pajisjeve në rrjetin qeveritar.

Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e sigurisë, standardizimin e infrastrukturës teknologjike dhe përmirësimin e mbështetjes teknike për stafin e BKK-së.

Tabela 8. Përmbledhje e aktiviteteve që ndërlidhen me projektin e ASHI-së

<i>Nr</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Rezultati</i>
1	<i>Kompjuterë të shtuar në domen</i>	<i>18</i>
2	<i>Kompjuterë të shtuar ne Active Directory</i>	<i>18</i>
3	<i>Bartje të dhënash</i>	<i>18 raste</i>

10. BUXHETI DHE FINANCAT

Gjatë vitit fiskal 2025, Biblioteka kombëtare e Kosovës ka operuar me një buxhet të miratuar prej (2,324,082.00€), të ndarë në pesë kategori kryesore: paga dhe mëditje (612,612.00 €); mallra dhe shërbime (271,000.00 €) shpenzime komunale (160,470.00 €); subvencione (30,000.00 €) dhe pasuri jofinanciare (1,250,000.00€).

Në kategorinë Paga dhe mëditje, buxheti tejkalohet për shkak të rritjes së pagave për një koeficient gjatë vitit. Në kategorinë Mallra dhe shërbime, mbetjet burojnë nga ndryshimi mes zotimit dhe tenderimit, pasi kompanitë kanë aplikuar me çmime më të ulëta, realizimi është 100%, duke përfshirë 15,500 € të bartura nga Shpenzimet komunale për furnizim me koleksione librash. Në kategorinë e Shpenzimeve komunale, shpenzimet kanë qenë më të ulëta, ndërsa të gjitha obligimet e vitit 2025 janë paguar, përveç faturave të muajit dhjetor që kanë ardhur pas mbylljes së zotimeve.

Tabela 9. Buxheti në formë tabelare për periudhën kohore janar-dhjetor 2025 në €

N r	Kategori ekonomike	Buxheti fillestar (€)	Buxheti përfundimtar (€)	Shpenzimet (€)	Realizimi (%)
1	<i>Paga dhe mëditje</i>	612,612.00	686,667.19	686,667.19	100%
2	<i>Mallra dhe shërbime</i>	271,000.00	286,500.00	262,650.64	I planifikuar 100% I realizuar 93.30% 23,849.36
3	<i>Shpenzime komunale</i>	160,470.00	144,970.00	102,876.32	42,093.68 71%
4	<i>Subvencione</i>	30,000.00	30,000.00	25,800.00	4,200.00 86%
5	<i>Pasuri jofinanciare</i>	1,250,000.00	479,184.00	402,937.50	76,246.50 84.10%
Gjithsej:		2,324,082.00	1,627,321.19	1,480,931.65	146,389.54 95%

Figura 28. Diagram i raportit të shpenzimeve kapitale





Figura 29. Diagram i shpenzimeve komunale



11. BURIMET NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese, Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka bërë një hap të rëndësishëm drejt nivelizimit të pagave të punonjësve, në përputhje me Ligjin nr. 08/L-197 për zyrtarët publik, duke i kategorizuar ata si krijues dhe performues të artit dhe kulturës. Ky veprim ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies dhe kushteve të punës, duke reflektuar në rritjen e cilësisë së punës dhe të shërbimeve.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 është jetësuar një praktikë e mirë institucionale përmes angazhimit të praktikantëve, në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit, dhe në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU) me Universitetin e Prishtinës – Qendra për Zhvillimin e Karrierës. Janë angazhuar gjithsej 12 praktikantë, 6 përmes ARPK-së dhe 6 përmes UP-së.

Përgjatë kësaj kohe, burimet njerëzore kanë menaxhuar në mënyrë sistematike proceset e personelit të Bibliotekës Kombëtare, duke përfshirë rekrutimet sipas kategorizimit performues i artit dhe kulturës, azhurnimin e pushimeve vjetore në sistemin SIMBNJ, si dhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të vijueshmërisë (SVP). Njëkohësisht, janë kompletuar dhe arkivuar dosjet personale, stafi është pajisur me karta identifikuese, dhe janë përditësuar sistemet përkatëse, në përputhje me procedurat ligjore të burimeve njerëzore.

Tabela 11. Përmbledhje e aktiviteteve të Burimeve njerëzore

<i>Nr</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Rezultati</i>
<i>1</i>	<i>Inicimi dhe pajisja me kartelë identifikuese për të gjithë punonjësit e Bibliotekës</i>	<i>I përfunduar</i>
<i>2</i>	<i>Rregullimi i sistemit të vijueshmërisë (SVP) si dhe mirëmbajtja e rregullët e tij</i>	<i>I përfunduar</i>
<i>3</i>	<i>Plotësimi i formularët për secilin punonjës dhe realizmi i procesit të fotografimit për ID</i>	<i>I përfunduar</i>
<i>4</i>	<i>Azhurnimi në sistemin SIMBNJ për menaxhimin e pushimeve vjetore.</i>	<i>Në proces</i>
<i>5</i>	<i>Materializimi i dokumentacionit zyrtar sipas ligjeve përkatëse</i>	<i>Në proces</i>
<i>6</i>	<i>Administrimi dhe arkivimi i dokumentacionit</i>	<i>Në proces</i>
<i>7</i>	<i>Menaxhimi i vijueshmërisë dhe pushimeve</i>	<i>Në proces</i>
<i>8</i>	<i>Rishikimi dhe kompletimi i dosjeve të personelit</i>	<i>I përfunduar</i>
<i>9</i>	<i>Zhvillimi i procedurave të personelit sipas detyrës dhe ligjeve në fuqi</i>	<i>Në proces</i>
<i>10</i>	<i>Hapja e konkurseve</i>	<i>10 shpallje/ 5 të suksesshme</i>

11.1. Ekuivalentimi i pagave të punonjësve profesionalë të Bibliotekës Kombëtare

Gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2025, Biblioteka Kombëtare ka adresuar disa kërkesa zyrtare radhazi pranë Drejtorisë së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP), me qëllim të ekuivalentimit të pagave për punonjësit profesionalë të Bibliotekës Kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, si institucion kulturor në varësi funksionale të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vepron në bazë të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe Ligjit Nr. 04/L-096 për Bibliotekat, i cili përcakton qartë statusin kulturor të institucioneve bibliotekare publike dhe rolin profesional të punonjësve të tyre.

Përmes kërkesave zyrtare, është kërkuar që punonjësit profesionalë të Bibliotekës Kombëtare të përfshirë në listën përkatëse të ekuivalentohen në kategorinë e krijuesve dhe përformuesve kulturorë, në përputhje me Shtojcën nr. 12 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/128, datë 16.02.2023. Kjo kërkesë është mbështetur edhe në rekomandimet dhe udhëzimet e mëhershme për ekuivalentim, të konfirmuara përmes komunikimeve zyrtare me komisionet përkatëse.

Megjithatë, kërkesat e Bibliotekës Kombëtare nuk janë aprovuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe nuk janë ekzekutuar nga Thesari i Kosovës, me arsyetimin se ato nuk kanë qenë të bazuara në planifikimin financiar dhe se komisionet për ekuivalentim pranë DMZP-së kanë përfunduar mandatin e tyre.

Në këto rrethana, menaxhmenti i Bibliotekës Kombëtare ka ndërmarrë hapa konkretë dhe të përgjegjshëm institucionalë, duke inicuar procesin e kategorizimit të punonjësve profesionalë si krijues dhe përformues arti e kulture, si dhe punonjës të trashëgimisë kulturore, në përputhje me planifikimin financiar të vitit 2025. Procesi është realizuar në mënyrë graduale, përmes dërgimit të kërkesave për rritje dhe rregullim pagash për grupe të ndryshme të punonjësve.

Si rezultat i këtyre veprimeve, gjatë vitit 2025, Biblioteka Kombëtare ka arritur që rreth 80% e punonjësve profesionalë t'i ekuivalentojë pagat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjatë vitit 2026, në kuadër të planifikimit financiar për këtë vit, pritet që ky proces të përmbyllet dhe të përmirësohet ndjeshëm situata e punonjësve profesionalë, duke siguruar kategorizim dhe kompensim të plotë në përputhje me ligjin.

11.2. Trajnimet

Gjatë kësaj periudhe raportuese, për të rritur efikasitetin dhe performancën e punonjësve, janë zhvilluar trajnime në fusha të ndryshme të bibliotekarisë, përfshirë katalogimin, përpunimin bibliografik dhe përdorimin e platformës KOHA, si dhe në administratë, me fokus në financa dhe prokurim publik. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale, zhvillimin e praktikave të punës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bibliotekare dhe administrative.

Tabela 10. Trajnimet e stafit në vitin 2025

<i>Nr</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Numri i pjesëmarrësve</i>
<i>1</i>	<i>Trajnim në fushën e katalogimit</i>	<i>Përshkrimi bibliografik i njësive CIP</i>	<i>14</i>
<i>2</i>	<i>Trajnim në përdorimin e teknologjisë për shërbimet e rrjetit bibliotekar KOHA</i>	<i>Përdorimi i platformës KOHA</i>	<i>5</i>
<i>3</i>	<i>Trajnim në fushën e prokurimit</i>	<i>Menaxhimi i kontratave në E-Prokurim</i>	<i>17</i>

4	Trajnim në fushën e financave	Trajnim për shpenzues	1
5	Trajnim në prokurim publik		1



Figura 30. Trajnimet e mbajtura në BKK

12. INFRASTRUKTURA, RESTAURIMI DHE INVESTIMET

Biblioteka Kombëtare e Kosovës gjatë këtij viti ka shënuar progres në përmirësimin e kushteve të infrastrukturës duke ndërhyre në disa prej hapësirave të saj, duke mbështetur vazhdimisht funksionimin teknik dhe logjistik të institucionit, duke kontribuar në mirëmbajtjen e infrastrukturës, pajisjeve dhe sistemeve teknologjike, në funksion të ofrimit të shërbimeve të pandërprera dhe efikase për stafin dhe përdoruesit e bibliotekës.

12.1. Rifunksionalizimi i amfiteatrit të vogël



Përmes donacionit nga Finca është rifunksionalizuar tërësisht amfiteatri i vogël i BKK-së, nga ndërhyrje të nevojshme në enterier, dysheme, ndriçim, mobiluar.

Figura 31. Renovimi i amfiteatrit të vogël

12.2. Funkcionalizimi i trezorit



Gjatë këtij viti është rregulluar dhe është funksionalizuar trezori i koleksioneve të veçanta në BKK, duke krijuar kushte më të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialeve me vlerë të veçantë.

Figura 32. Trezori i Koleksioneve të Veçanta në BKK

12.3. Rregullimi i sallës së periodikut



Salla e periodikut është rikthyer në një hapësirë funksionale për lexuesit dhe hulumtuesit, duke ofruar një ambient të qetë dhe komod për leximin e gazetave dhe revistave që shërbehen çdo ditë nga Divizioni i Shërbimit të Përdoruesve.

Figura 33. Salla e periodikut e rifunksionalizuar

12.4. Pastrimi i mureve



Gjatë këtij viti u realizua pastrimi dhe fshirja e dhjetëra shkrimeve, mbishkrimeve dhe vizatimeve të papërshtatshme nga muret e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, të cilat kishin qëndruar për vite me radhë. Kjo ndërhyrje kontribuoi në përmirësimin e imazhit institucional të BKK-së dhe në ruajtjen e dinjitetit të hapësirës publike dhe kulturore.

Figura 34. Pastrimi i mureve të jashtme të BKK-së

12.5. Pajisjet teknologjike

Gjatë këtij viti, Biblioteka Kombëtare e Kosovës u furnizua me pajisje të reja teknologjike, përfshirë kompjuterë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve mbështetjen e punës së stafit.

12.6. Mirëmbajtja e klimakomoreve dhe pajisja me klimakomore të reja

Gjatë vitit, sistemet ekzistuese të klimave janë servisuar dhe mirëmbajtur rregullisht, ndërsa janë blerë dhe instaluar klima të reja për të përmirësuar kushtet e ambientit për punonjësit dhe vizitorët.

12.7. Pajisja me automjete


Përmes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Biblioteka Kombëtare e Kosovës është pajisur me tri automjete të reja.

13. PROMOVIMI, SHËRBIMET DHE VIZITORËT

13.1. Mediet dhe rrjetet sociale

Gjatë vitit 2025, Biblioteka Kombëtare ka shënuar një rritje të ndjeshme të interesimit të medieve ndaj aktiviteteve dhe shërbimeve të saj. Institucioni ka vijuar të ofrojë bashkëpunim aktiv me median, duke siguruar transparencë të plotë institucionale dhe promovuar në mënyrë sistematike aktivitetet, shërbimet dhe iniciativat e Bibliotekës. Gjithashtu, gjatë këtij viti, Biblioteka Kombëtare ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet dhe shërbimet që ofron përmes mediave dhe rrjeteve sociale, duke rritur dukshmërinë institucionale dhe duke lehtësuar qasjen e publikut ndaj informacionit. Si rezultat i këtij angazhimi të shtuar, gjatë vitit është vërejtur një rritje e ndjeshme e ndjekjes dhe frekuentimit të profileve zyrtare në krahasim me vitin 2024.

Figura 35. Diagram krahasimi mes ndjekjes në rrjete sociale në vitin 2024 dhe 2025



13.2. Vizitorët

Biblioteka Kombëtare vazhdon të mbetet një destinacion i rëndësishëm për vizitorët. Gjatë vitit 2024, institucioni është vizituar nga 12,104 vizitorë, ndërsa në vitin 2025 është shënuar një rritje e konsiderueshme, me gjithsej 47,346 vizitorë. Kjo rritje e ndjeshme dëshmon interesimin në rritje të publikut për shërbimet, fondet dhe aktivitetet e Bibliotekës Kombëtare, si dhe efektin pozitiv të promovimit dhe hapjes më të madhe ndaj komunitetit.




Figura 36. Krahasim i numrit të vizitorëve në BKK në vitin 2024 dhe 2025

14. FINANCAT DHE PROKURIMI

14.1 Procedurat e prokurimit

Gjatë vitit 2025 janë iniciuar gjithsej 44 procedura të prokurimit. Prej tyre dhjetë janë që janë anuluar për arsye ligjore. Tetë procedura nga ato të anuluarat janë ri-enderuar. Kontrata të nënshkruara janë gjithsej 33, nga të cilat një është e ndërprerë për arsye të mosrealizimit nga ana e operatorit ekonomik. Një procedurë është inicuar dhe është në fazën e tenderimit dhe e cila nuk pritet që të realizohet në vitin 2025.

Vlen të theksohet se zyra e prokurimit ka qenë në vazhdimësi e përkushtuar që të respektohet planifikimi i prokurimit dhe Ligji për Prokurim Publik, gjë e cila është arritur në masën e duhur duke respektuar të gjitha normat dhe afatet ligjore.

Tabela 11. Procedurat e prokurimit në BKK sipas periudhave kohore

Periudha	Nr. i procedurave	Shuma e kontraktuar
TM1	6	24,455.48 €
TM2	5	24,255.00 €
TM3	10	182,825.00 €
TM4	13	303,131.86 €
TOTALI	33	534,667.34 €

Figura 37. Raporti i prokurimit për vitin 2025 i shprehur sipas numrit të procedurave të iniciuara




Figura 38. Raporti i prokurimit për vitin 2025 në bazë të vlerës së kontraktuar




Tabela 12. Lista e procedurave të prokurimit

Procedurat	Përshkrim	Statusi	Vlera
Procedura nga viti 2024 Angazhim i një eksperti për përpunimin e materialeve orientale për nevojat e BKK-së- Ritenderim Nr i Prokurimit ^[1] 90900-24-12712-2-2-1 Nr i brendshëm	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	20,880.00 €
Procedura Sigurim kasko- Peugeot 308 Nr i Prokurimit ^[2] 90900-25-739-2-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-001-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	696,20 €
Procedura Furnizimi dhe montimi i tepihave në zyret 35 A dhe zyra kati IV Nr i Prokurimit ^[3] 90900-25-818-1-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-002-1-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	519.42 €
Procedura Rregullimi i ndriqimit tek hyrja e studentëve dhe rrethi tek toaletet e studentëve Nr i Prokurimit ^[4] 90900-25-1206-2-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-003-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Anulimi i tenderit	E anuluar	
Procedura Rregullimi i ndriqimit tek hyrja e studentëve dhe rrethi tek toaletet e studentëve - Ri-tenderim Nr i Prokurimit ^[5] 90900-25-1974-2-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-004-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	958.40 €

Procedura Sherbime me Domain dhe Hosting për platformen elektronike për projektin Kujtesa e Kosovës - Histori Gojore Nr i Prokurimit ^[6] 90900-25-1980-2-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-005-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	741.46 €
Procedura Riparimi dhe rivitalizimi i trezorit të BKK-së në depon nr.030 kati-2 Nr i Prokurimit ^[7] 90900-25-1995-2-2-1 Nr i brendshëm 90900-25-006-2-2-1	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	17,670.00 €
Procedura Meremetimi dhe rregullimi i inventarit për nevoja të BKK-së Nr i Prokurimit ^[8] 90900-25-2092-5-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-007-5-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	660.00 €
Procedura Shërbime për mirëmbajtjen e hapsirës gjelbëruese rreth BKK-së për vitin 2025 Nr i Prokurimit ^[9] 90900-25-2867-2-3-6 Nr i brendshëm 90900-25-008-2-3-6	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	2,920.00 €
Procedura Shërbime për pastrimin e mureve të jashtme të BKK-së nga mbishkrimet e ndryshme Nr i Prokurimit ^[10] 90900-25-3380-2-3-6 Nr i brendshëm 90900-25-009-2-3-6	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	1,850.00 €

<p>Procedura Rregullimi, servisimi dhe mbushja e aparateve për mbrojtje nga zjarri dhe hidranteve në BKK Nr i Prokurimit^[11] 90900-25-3421-2-3-6 Nr i brendshëm 90900-25-010-2-3-6</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>919.00 €</p>
<p>Procedura Sanimi dhe rregullimi i rrjedhjes së ujit në katin I dhe II në objektin e BKK-së Nr i Prokurimit^[12] 90900-25-3471-2-4-7 Nr i brendshëm 90900-25-011-2-4-7</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>896.00 €</p>
<p>Procedura Furnizim me paisje të Teknologjisë Informative për nevojat e BKK-së - Ritenderim Nr i Prokurimit^[13] 90900-25-4789-5-5-8 Nr i brendshëm 90900-25-012-5-5-8</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Kërkesa për Rishqyrtim Vendim lidhur me kërkesën për Rishqyrtim Pezullim i aktivitetit të prokurimit Vendim nga OSHP Nënshkrimi i kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>37,572.50 €</p>
<p>Procedura Furnizim dhe Montim i Klimave, Aparateve për Ujë, Tharëseve për duar dhe servisim i klimave Nr i Prokurimit^[14] 90900-25-5576-1-2-1 Nr i brendshëm 90900-25-013-1-2-1</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës Ndërprerja e kontratës për Lotin 2</p>	<p>E kontraktuar E ndërprerë vlera 4,275.00€</p>	<p>10,478.00 €</p>

Procedura Furnizim me libra për koleksionet e BKK-së Nr i Prokurimit ^[15] 90900-25-5592-1-2-1 Nr i brendshëm 90900-25-014-1-2-1	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	19,162.00 €
Procedura Angazhimi i një Eksperti Ligjor për nevojat e BKK-së Nr i Prokurimit ^[16] 90900-25-6006-2-3-6 Nr i brendshëm 90900-25-015-2-3-6	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	5,850.00 €
Procedura Shërbime të shtypjes, botimeve dhe furnizim me material të nevojshëm për BKK-në Nr i Prokurimit ^[17] 90900-25-6087-5-5-8 Nr i brendshëm 90900-25-016-5-5-8	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	16,372.50 €
Procedura Krijimi i Rrjetit Bibliotekar në Kosovë- Ritenderim hera e katërt Nr i Prokurimit ^[18] 90900-25-6687-2-2-1 Nr i brendshëm 90900-25-017-2-2-1	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Kërkesa për Rishqyrtim Pezullim i aktivitetit të prokurimit Vendim lidhur me kërkesën për Rishqyrtim Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	71,808.00 €

<p>Procedura Shërbime Audiovizuale, Përkthimit Simultant, Marketingut për nevojat e BKK-së Nr i Prokurimit^[19] 90900-25-6896-2-2-1 Nr i brendshëm 90900-25-018-2-2-1</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>16,897.00</p>
<p>Procedura Shërbime të Skanimit, indeksimit dhe konvertimit me OCR i materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "P. Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital në BKK Nr i Prokurimit^[20] 90900-25-7001-2-2-1 Nr i brendshëm 90900-25-019-2-2-1</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Anulimi i procedurës</p>	<p>E anuluar</p>	
<p>Procedura Servisimi dhe funksionalizimi i sistemit të kamerave CCTV të BKK-së Nr i Prokurimit^[21] 207/90900-25-7387-2-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-020-2-4-7</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>790.00 €</p>
<p>Procedura Furnizim dhe montim i derës Nr i Prokurimit^[22] Nr i brendshëm</p>		<p>E dështuar</p>	
<p>Procedura Shërbime për ngjyrosje, pastrimin dhe rregullime të tjera në Sallën e Periodikut - Kati II Nr i Prokurimit^[23] 207/90900-25-7420-2-3-6 Nr i brendshëm 207/90900-25-022-2-3-6</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>3,895.00 €</p>

<p>Procedura Furnizim me licenca të softëtare asistues për të verbërit për nevojat e BKK-së</p> <p>Nr i Prokurimit^[24] 207/90900-25-7916-1-3-6</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-023-1-3-6</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Anulimi i procedurës</p>	<p>E anuluar</p>	
<p>Procedura Shërbime të Skanimit, indeksimit dhe konvertimit me OCR i materialeve bibliotekare të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "P. Bogdani", si dhe krijimi i arkivit të tyre digjital në BKK - Ritenderim</p> <p>Nr i Prokurimit^[25] 207/90900-25-8169-2-1-1</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-024-2-1-1</p>	<p>Njoftimi për kontratë Raporti i vlerësimit</p> <p>Njoftimi mbi vendimin e AK</p> <p>Përgaditja e Draftit të Kontratës dhe nënshkrimi i saj nga ana e AK. Kontrata pritet të nënshkruhet edhe në ministri</p> <p>Nënshkrimi i Kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>270,000.00 €</p>
<p>Furnizim me Paisje Teknologjike për mbështetjen e integritetit në ASHI për BKK-në</p> <p>Nr i Prokurimit^[26] 207/90900-25-8817-1-3-6</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-025-1-3-6</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Nënshkrimi i kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>983.00 €</p>
<p>Procedura Rregullimi dhe servisimi i automjetit të BKK-së - Kombi Reno me tabela 01-627-BI</p> <p>Nr i Prokurimit^[27] 207/90900-25-9370-2-4-7</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-026-2-4-7</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave</p> <p>Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Procedura është në afat për anulim</p> <p>Procedura është anuluar</p>	<p>E anuluar</p>	
<p>Procedura Furnizim me Libra për koleksionet e BKK-së</p> <p>Nr i Prokurimit^[28] 207/90900-25-9456-1-2-1</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-027-1-2-1</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Nënshkrimi i kontratës</p>	<p>E kontraktuar</p>	<p>15,330.00 €</p>

<p>Procedura Furnizim dhe montim i Aparateve të ujit dhe Furnizim dhe montim i Tharseve për duar me sensor-Ritenderim</p> <p>Nr i Prokurimit^[29] 207/90900-25-9490-1-3-6</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-028-1-3-6</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Anulimi i procedurës</p>	E anuluar	
<p>Procedura Furnizim dhe montim i filtrave në Klimakomoret e BKK-së</p> <p>Nr i Prokurimit^[30] 207/90900-25-9499-1-3-6</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-029-1-3-6</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Anulimi i procedurës</p>	E anuluar	
<p>Procedura Servisimi dhe rregullimi i Liftit nr.1 në BKK</p> <p>Nr i Prokurimit^[31] 207/90900-25-9576-2-4-7</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-030-2-4-7</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave</p> <p>Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Procedura është anuluar</p>	E anuluar	
<p>Procedura Angazhimi i një eksperti për shërbime të dizajnit grafik për nevojat e BKK-së</p> <p>Nr i Prokurimit^[32] 207/90900-25-9641-2-2-1</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-031-2-2-1</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Anulimi i procedurës</p>	E anuluar	
<p>Procedura Furnizim me ndarëse të ambientit me shirit 1.5m me mbajtëse dhe shtylla nga inoksi</p> <p>Nr i Prokurimit^[33] 207/90900-25-10285-1-4-7</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-032-1-4-7</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave</p> <p>Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Nënshkrimi i Kontratës</p>	E kontraktuar	486.00 €
<p>Procedura Rregullimi dhe servisimi i automjetit të BKK-së - Kombi Reno me tabela 01-627-BI-Ritenderim</p> <p>Nr i Prokurimit^[34] 207/90900-25-10287-2-4-7</p> <p>Nr i brendshëm 207/90900-25-033-2-4-7</p>	<p>Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave</p> <p>Njoftimit mbi Vendimin e AK</p> <p>Nënshkrimi i kontratës</p>	E kontraktuar	955.00 €

Procedura Furnizim me Uniforma për Punëtorët e Sigurimit dhe Mirëmbajtjes të BKK-së Nr i Prokurimit ^[35] 207/90900-25-10381-1-3-6 Nr i brendshëm 207/90900-25-035-1-3-6	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Anulimi i procedurës	E anuluar	
Procedura Furnizim dhe montim i filtrave në Klimakomoret e BKK-së- Ritenderim Nr i Prokurimit ^[36] 207/90900-25-10515-1-3-6 Nr i brendshëm 207/90900-25-036-1-3-6	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	6,900.00 €
Procedura Furnizim me Tableta 8,7 ; 8 128 Nr i Prokurimit ^[37] 207/90900-25-10377-1-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-25-037-1-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	960.00€
Procedura Furnizim me nxemse të ndryshme elektrike për nevojat e BKK-së Nr i Prokurimit ^[38] 207/90900-25-10668-1-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-25-038-1-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	827.00 €
Procedura Furnizim dhe montim i Aparateve të ujit dhe Furnizim dhe montim i Tharseve për duar me sensor- Ritenderim hera e dytë Nr i Prokurimit ^[39] 207/90900-25-10750-1-3-6 Nr i brendshëm 207/90900-25-039-1-3-6	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave dhe krijimi i komisionit vlerësues Nënshkrimi i raportit të vlerësimit dhe nxjerrja e Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i kontratës	E kontraktuar	5,370.00 €
Procedura Sigurim i automjetit Peugeot 308 Nr i Prokurimit ^[40] 207/90900-25-10817-2-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-25-040-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	178.11 €

Procedura Sigurim i automjetit Reno Kombi Nr i Prokurimit ^[41] 207/90900-25-10824-2-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-25-041-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Procedura është anuluar	E anuluar	
Procedura Furnizim me material për higjienë për nevojat e BKK-së Nr i Prokurimit ^[42] 207/90900-25-10856-1-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-25-042-1-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	948.50 €
Procedura Sigurim i automjetit Reno Kombi- Ritenderim Nr i Prokurimit ^[43] 207/90900-25-11010-2-4-7 Nr i brendshëm 207/90900-25-043-2-4-7	Njoftimi për kontratë Hapja e ofertave Njoftimit mbi Vendimin e AK Nënshkrimi i Kontratës	E kontraktuar	194.25 €
Procedura Angazhimi i një eksperti për shërbime të dizajnit grafik për nevojat e BKK-së- Ritenderim Nr i Prokurimit ^[44] 207/90900-25-11192-2-2-1 Nr i brendshëm 207/90900-25-044-2-2-1	Njoftimi për kontratë	Në proces	

15. SFIDAT

Gjatë vitit raportues 2025, Biblioteka Kombëtare e Kosovës është përballur me disa sfida që kanë ndikuar në dinamikën dhe efikasitetin e funksionimit institucional. Një nga sfidat kryesore ka qenë mungesa e stafit profesional. Pavarësisht rekrutimit të disa kuadrove të reja gjatë vitit, kapacitetet njerëzore kanë mbetur të pamjaftueshme për realizimin e plotë të të gjitha proceseve të punës, duke marrë parasysh zgjerimin e vazhdueshëm të veprimtarive dhe nevojat e rritura të Bibliotekës. Kjo mungesë është reflektuar në mënyrë të veçantë në njësinë e teknologjisë informative, në shërbimet për përdorues, në njësinë e depove dhe koleksioneve, si dhe në përgjithësi në të gjitha njësitë organizative.

Një tjetër sfidë e evidentuar në vitin 2025, që lidhet me aspektin e rregullimit administrativ, është mungesa e një rregulloreje të re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e cila do të mundësonte funksionimin më të qartë dhe më efikas të strukturës organizative. Mungesa e kësaj rregulloreje ka ndikuar në pamundësinë që punonjësit të veprojnë plotësisht në përputhje me detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara.

Në këtë kuadër, sfidë ka qenë edhe ekuivalentimi i pagave për punonjësit profesionalë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat dhe statusin e stafit. Pavarësisht kërkesave dhe iniciativave të ndërmarra nga menaxhmenti, procesi ka përballuar vështirësi administrative dhe procedurale, duke ndikuar në vonesa për rregullimin e plotë të kompensimit të punonjësve. Kjo sfidë nënvizon nevojën për mbështetje institucionale dhe koordinim më të qartë me organet përgjegjëse qeveritare, për të garantuar funksionimin efektiv të strukturës dhe motivimin profesional të stafit.

Gjithashtu, edhe në infrastrukturën fizike të Bibliotekës janë identifikuar disa problematika që kanë paraqitur probleme serioze gjatë vitit 2025, veçanërisht në hapësirat e depove. Janë evidentuar rrjedhje uji, mosfunksionim i sistemeve të drenazhimit, izolimit, kanalizimit, klimatizimit dhe ujësjellësit, si dhe vjetërsia e instalimeve ekzistuese. Këto probleme kanë krijuar rrezik të vazhdueshëm për koleksionet bibliotekare, duke pasur raste të përsëritura të rrjedhjeve dhe çarjeve të gypave të kanalizimit dhe ujësjellësit. Po ashtu, transportieri i librit nuk ka qenë në nivelin e duhur funksional, duke ndikuar në qarkullimin e materialeve bibliotekare.

Megjithatë, Biblioteka Kombëtare ka operuar me pritshmërinë se investimet e planifikuara në fushën e konservimit dhe restaurimit, të parashikuara në Master Planin e Bibliotekës Kombëtare, do të kontribuojnë në përmirësimin e ndjeshëm të kushteve infrastrukturore dhe teknike.

16. PRIORITETET PËR VITIN 2026

Prioritetet kryesore për vitin 2026 të Bibliotekës Kombëtare do të jenë modernizimi i shërbimeve dhe digjitalizimi i fondeve me focus zgjerimin e procesit të digjitalizimit të koleksioneve të veçanta dhe të periodikut historik të Kosovës, duke cuar numrin total të materiale bibliotekare deri në 4 milion; pastaj përmirësimi i platformës digjitale dhe integrimi i teknologjive të reja për përdoruesit.

Prioritet do të ketë konsolidimi dhe funksionalizimi i Rrjetit Bibliotekar të Kosovës, harmonizimi i standardeve profesionale për të gjitha bibliotekat publike si dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave komunale dhe institucioneve qendrore.

Na aspektin e forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale do të punohet në përfundimin e procesit të ekuivalentimit të pagave për punonjësit profesionalë, si dhe në mbajtjen e trajnimeve të specializuara dhe përmirësimin e strukturave menaxheriale.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës gjatë vitit 2026, do të fokusohet në zgjerimin e ndikimit publik dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të diplomacisë kulturore, përmes organizimit të aktiviteteve kulturore dhe shkencore, promovimit të leximit, pjesëmarrjes në iniciativa ndërkombëtare dhe krijimit të marrëveshjeve me partnerë homologë, duke rritur vizibilitetin dhe pozicionin e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

17. ANEKS

- Lista e marrëveshjeve
 1. Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës
 2. Marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Historisë "Ali Hadri"
 3. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës
 4. Marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Filozofik
 5. Marrëveshje bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë
 6. Marrëveshje bashkëpunimi MKRS – IKKL – BKK – MZK – UP